

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6084  
E martë, 11 gusht 2020  
çmimi 0.40 €

## Presidenti Thaçi krijon urdhrin "Adem Demaçi"

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", BELUL BEQAJ | FAQE 4-5

# ZGJEDHJET, MË SË LARGU NË VJESHTË

Politologu Belul Beqaj ka paralajmëruar se vendi mund të shkojë shumë shpejt në zgjedhje të reja. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se ato do të mund të shkaktohen më

së largu deri në vjeshtë të këtij viti. Sipas tij, vetëm qeveria e re do të mund ta vazhdojë dialogun për normalizim të marrëdhënieve Kosovë - Serbi. Beqaj ka deklaruar se qeveria Hoti ka qenë në

kundërshtim me vullnetin politik të shumicës së qytetarëve të Kosovës. Ai e ka ftuar PDK-në që ta përkrahë mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë të cilin e ka iniciuar Lëvizja Vetëvendosje



## KURTI KËRKON NDIHMËN E AMBASADORËVE PËR TA SHMANGUR KATASTROFËN HUMANITARE NË KOSOVË

Lideri i Vetëvendosjes, nëpërmjet një letre publike drejtuar ambasadorëve të akredituar në Kosovë, ka kërkuar nga ta që t'i ndihmojnë institucionet shëndetësore të Kosovës për tejkalimin e krizës me pandeminë Covid-19. "Tani, në emër të popullit të Kosovës, publikisht ju kërkoj juve

dhe vendeve tuaja që t'ua siguronin institucioneve të kujdesit shëndetësor të Kosovës pajisjet e nevojshme mjekësore dhe burimet njerëzore për të mundësuar parandalimin e krizës shëndetësore që të shndërrohet në katastrofë humanitare", ka shkruar Kurti në letër | FAQE 2

## MSH-JA LICENCON 29 LABORATORË PRIVATË PËR KRYERJEN E TESTEVE PËR COVID

FAQE 5



**RENOVA**  
PUTZ

Maqedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)



NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE

INFO: 049-111-101,  
044-511-177

[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË



**Kolegji  
BIZNESI**

[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**

Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

### OPINION

UÇK-JA SI FORCË E LIRISË SHPËTOI NJË KOMB PREJ GODITJEVE TERRORISTE SERBE (28) F. 11

Shkruan:  
Kudusi LAMA



### AKTUALE

DEPUTETJA HOXHA KËRKON NGA QEVERIA T'I KRIJOJË KUSHTET PËR KTHIMIN E FËMIJËVE NË SHKOLLA F. 7

MOLLIQAJ, HYSENIT: MARRËVESHJA FINALE ME SERBINË NUK MUND TË MARRË FORMË PA SHBA-në F. 5

PËRKUJTOHET "ABEJA" ME SHOKË F. 2



### EKONOMI

MIRATOHET MARRËVESHJA E HUAS NDËRMJET KOSOVËS DHE BE-së NË VLERË PREJ 100 MILIONË EUROVE F. 9

TRUSTI: JEMI NË PRITJE TË NDRYSHIMEVE LIGJORE PËR TËRHEQJEN E 10 PËR QIND TË MJETEVE F. 9

PËRFAQËSUESIT E BIZNESEVE DISKUTOJNË ME MINISTRIN KUÇI PËR RIMËKËMBJEN EKONOMIKE F. 9



22 vjet më parë ka rënë në fushën e nderit hero i Bekim Berisha-“Abeja” me bashkëluftëtarë

## Përkujtohet ‘Abeja’ me shokë

Në 22-vjetorin e rënies heroike, liderët institucionalë kanë përkujtuar Bekim Berishën, Bedri Shalën, Elton Zherkën dhe Përmet Vulën. Duke e vlerësuar lart kontributin e tyre për liri, ata kanë thënë se lufta heroike e këtyre dëshmorëve rriti moralin dhe motivimin e ushtarëve të UÇK-së për ta vazhduar rezistencën e armatosur deri në çlirimin e atdheut

### “Epoka e re”

**PRISHTINË, 10 GUSHT** - Liderët institucionalë dhe politikë të Kosovës kanë përkujtuar Bekim Berishën, Bedri Shalën, Elton Zherkën dhe Përmet Vulën të cilët kanë rënë heroikisht 22 vjet më parë.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka deklaruar se kontributi i trimave për t’ia ndalur hovin regjimit të Millosheviqit, në tërë territorin e ish-Jugosllavisë ishte çdoherë i lartë. “Disa prej këtyre trimave, që i luftuan heroikisht forcat policore dhe ushtarake të Serbisë, ishin edhe Bekim Berisha, Bedri Shala, Elton Zherka dhe Përmet Vula. Bekim Berisha luftoi në Kroaci e Bosnje dhe padyshim që gjaku i tij shqiptar nuk e linte asnjëherë që të mos u bashkohej radhëve të UÇK-së dhe luftës sonë të

drejtë për çlirimin e Kosovës. Me guximin dhe përvojën e tij luftarake, ‘Abeja’ dha kontribut të madh për ta shuar njëherë e përgjithmonë ëndrrën e regjimit serb për një Serbi të Madhe një etnike. Meritat dhe heroizmin e tij i vlerëson lart edhe shteti i Kroacisë”, ka shkruar Thaçi në profilin e vet në “Facebook”, duke shtuar se Bekim Berisha, Bedri Shala, Elton Zherka dhe Përmet Vula dhanë kontribut të pakrahasueshëm në luftën e UÇK-së derisa ranë heroikisht 22 vjet më parë, më 10 gusht 1998, kur iu bashkuan përjetësisht dëshmorëve që u flijuan për lirinë e Kosovës.

Edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka përkujtuar heronjtë Bekim Berisha-Abeja, Bedri Shala, Elton Zherka, Përmet Vula, Bashkim Leku dhe Jusuf Kelmendi. Përmes një postimi në llogarinë e vet në “Facebook”, Haradinaj ka



vlerësuar lart figurën e këtyre luftëtarëve të pashoq, trima e atdhetarë të cilët para jetës së tyre kishin lirinë e popullit të shtypur. “Në 22-vjetorin e rënies, sot kujtojmë heronjtë Bekim Berisha-Abeja, Bedri Shala, Elton Zherka, Përmet Vula, Bashkim Leku dhe Jusuf Kelmendi. Luftëtarë të pashoq, trima e atdhetarë të cilët para jetës së vet e kishin lirinë e

popullit të shtypur, e në rastin e Abejës edhe përtej Kosovës”, ka shkruar Haradinaj.

Kurse lideri i Nismes Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka se Bekim Berisha (Abeja), bashke me bashkëluftëtarët e vet, ranë 22 vjet me pare ne fushen e nderit per te mos vdekur kurrë. “Kosova sot nderon dhe perkujton me pietet te larte heronjtë e kombit Bekim

Berisha-Abeja, Bedri Shala, Elton Zherka dhe Permet Vula. Bekim Berisha-Abeja bashke me bashkeluftëtarët e tij ranë 22 vjet me pare ne fushen e nderit per te mos vdekur kurrë. Kontributi i Bekim Berishes, si një luftëtar i zoti dhe strateg i shquar, ishte jashtëzakonisht i madh, pasi ai kishte marre pjese edhe ne luften kundër serbeve ne Kroaci dhe Bosnje”, ka shkruar Limaj.

## Kurti kërkon ndihmën e ambasadorëve për ta evituar katastrofën humanitare në Kosovë

Lideri i Vetëvendosjes, nëpërmjet një letre publike drejtuar ambasadorëve të akredituar në Kosovë, ka kërkuar nga ta që t’i ndihmojnë institucionet shëndetësore të Kosovës për tejkalimin e krizës me pandeminë Covid-19. “Tani, në emër të popullit të Kosovës, publikisht ju kërkoj juve dhe vendeve tuaja që t’ua siguronit institucioneve të kujdesit shëndetësor të Kosovës pajisjet e nevojshme mjekësore dhe burimet njerëzore për të mundur parandalimin e krizës shëndetësore që të shndërrohet në katastrofë humanitare”, ka shkruar Kurti në letër



**PRISHTINË, 10 GUSHT (ER)** - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, u ka dërguar letër publike ambasadorëve të huaj në Kosovë rreth situatës me Covid-19. Në letrën drejtuar ambasadorëve, Kurti ka kërkuar nga ta që t’i ndihmojnë institucionet shëndetësore të Kosovës në përballje me Covid-19 për shpëtimin e jetës së njerëzve. “Siç mund ta dini, situata me Covid-19 në dy muajt e

fundit është bërë dramatike. Deri më tani 341 persona kanë vdekur, 10 419 janë infektuar, dhe 4 020 janë raste aktive. Në dy javët e fundit kemi pasur mesatarisht dhjetë vdekje në ditë, duke e renditur Kosovën të parën në botë për numrin e vdekjeve nga Covid-19 për milion banorë. Për çdo ditë kemi qindra raste pozitive ku më shumë se 50 për qind të personave të testuar rezultojnë pozitivë. Duke pasur parasysh

se qeveria në mënyrë drastike ka ulur gjurmimin e kontakteve, numri i të infektuarve është shumëfish më i lartë, që paraqet rrezik edhe më të madh nëse më shumë njerëz do të kenë nevojë për shtrim në spital. Burimet teknike dhe njerëzore të institucioneve të kujdesit shëndetësor janë shteruar, kurse spitalet nuk kanë më kapacitete akomoduese. Të gjitha Njësitë e Kujdesit Intensiv janë të zëna,

ndërsa mjekët, specialistët dhe infermierët punojnë ditë e natë nën trysni dhe stres të jashtëzakonshëm. Më shumë se 1 000 punëtorë të kujdesit shëndetësor janë infektuar, që shfaq nevojën për më shumë staf mjekësor”, ka shkruar Kurti në letrën e vet. Sipas kësaj letre, është thënë se furnizimet esenciale mjekësore që nevojiten për ta luftuar Covid-19 janë duke mbaruar dhe nëse kjo situatë dramatike vazhdon, së shpejti nuk do të ketë oksigjen të mjaftueshëm për t’i shpëtuar pacientët. “Si lider i opozitës, është detyra ime që ta mbaj përgjegjëse qeverinë aktuale edhe në kohë të emergjencës kombëtare. Më vjen keq që nuk kemi një qeveri e cila vepron me përgjegjësi dhe profesionalizëm, që dëgjon shkencëtarët dhe ekspertët dhe që gëzon besim dhe kredibilitet midis qytetarëve. Virusit në vetvete nuk është vepër e qeverisë, por dështimi për të vepruar me përgjegjësi është rezultat i

drejtpërdrejtë i paaftësisë së saj, çka vuri në rrezik gjithë vendin. Në këtë situatë tejet të rënduar unë nuk mund të qëndroj i qetë derisa shoh një krizë shëndetësore që po degjenerohet në humanitare, duke kërcënuar jetët e mijëra qytetarëve të Kosovës”, ka shkruar Kurti, duke shtuar se ka kërkuar nga ambasadorët e huaj të parandalojnë që një krizë shëndetësore të shndërrohet në një katastrofë humanitare. “Ambasadorë dhe diplomatë të nderuar, unë i kam shprehur këto vështrime me ju shumë herë në takimet tona. Tani, në emër të popullit të Kosovës, publikisht ju kërkoj juve dhe vendeve tuaja që t’ua siguronit institucioneve të kujdesit shëndetësor të Kosovës pajisjet e nevojshme mjekësore dhe burimet njerëzore për të mundur parandalojmë që një krizë shëndetësore të shndërrohet në një katastrofë humanitare”, ka shkruar Kurti në letrën drejtuar ambasadorëve të akredituar në Kosovë.



# Kosovë: 14 të vdekur, 114 të shëruar dhe 172 raste të reja me Covid-19 në 24 orët e fundit

Gjatë 24 orëve të fundit në Kosovë janë paraqitur 172 raste pozitive me Covid-19, po nga ky infeksion kanë vdekur 14 persona dhe nga i njëjti janë shëruar 114 të tjerë. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se numri i përgjithshëm i të prekurve nga virusi Korona ka shkuar në 10 419, i të vdekurve në 341 dhe i të shëruarve në 6 058

**EPOKA  
ERE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 10 GUSHT** - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se në 24 orët e fundit në vendin tonë kanë vdekur 14 persona si pasojë e Covid-19 dhe janë paraqitur 17 raste të reja me koronavirus. Po ky institut ka bërë se gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 114 persona, të cilët kanë qenë të infektuar me virusin Korona. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK, me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 506 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren prej të cilëve rezultojnë 172 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar 14 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Numri total i rasteve pozitive është 10 419 raste nga 41 152 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 341 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit, janë shëruar 114 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 6 058 raste, kurse numri i rasteve aktive është 4 020", ka njoftuar IKShPK-ja, duke njoftuar se rastet pozitive janë nga Prishtina, Gjilani, Mitrovica etj. "Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 78 raste, komuna Gjilan 19 raste,

komuna Mitrovicë 15 raste, komuna Fushë Kosovë 9 raste, komuna Pejë 8 raste, komuna Viti 7 raste, komuna Skenderaj 6 raste, komuna Drenas 5 raste, komuna Obiliq 5 raste, komuna Vushtrri 4 raste, komuna Kamenicë 3 raste, komuna Lipjan 3 raste, komuna Podujevë 2 raste, komuna Rahovec 2 raste dhe me nga një rast komunat Ferizaj, Gjakovë, Istog, Klinë, Prizren dhe Shtime", ka njoftuar IKShPK-ja.

## MSh-ja licencën 29 laboratorë private për kryerjen e testeve për Covid

Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka publikuar listën e institucioneve shëndetësore private të cilat janë licencuar për kryerjen e testeve serologjike dhe PCR për koronavirus. Bordi për licencim të institucioneve private shëndetësore deri tash ka shqyrtuar 34 aplikacione (prej mbi 100 sa kanë aplikuar) të institucioneve private shëndetësore, të cilat kanë bërë kërkesa për lejimin e shërbimit të testeve për SARS-Cov 2. Nga aplikacionet e shqyrtuara për teste molekulare dhe serologjike për SARS Cov-2, Bordi ka konstatuar se në bazë të dëshmimeve të prezantuara në aplikacion, 29 prej këtyre



institucioneve i plotësojnë kriteret për kryerjen e testeve për SARS Cov-2. Prej 29 këtyre institucioneve shëndetësore të licencuara, 27 do të aplikojnë teste serologjike, ndërsa 2 të tjera do të kryejnë teste molekulare (RT-PCR).

Bordi për licencim të institucioneve private shëndetësore do ta vijojë shqyrtimin edhe të aplikacioneve të tjera gjatë gjithë javës dhe në listën e radhës do të publikohen edhe emrat e institucioneve të tjera të cilave do t'u lejohet kryerja e testeve për SARS-Cov-2. Gjithashtu, nga sot (e martë) Inspektorati Shëndetësor do të kryejë inspekte në institucionet të cilave u është lejuar kryerja e testeve, për ta inspektuar gatishmërinë e tyre për t'i kryer testimet dhe

## Punëtorët shëndetësorë do t'i marrin edhe nga 300 euro shtesë

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka njoftuar se ka kërkuar nga kryeministri Avdullah Hoti që punonjësve shëndetësorë t'u paguhet shtesa në të ardhura personale deri në 300 euro në muaj, bazuar në kategorizimin e bërë sipas rrezikshmërisë së drejtpërdrejtë nga virusi Covid-19. Kjo kërkesë ka gjetur mbështetjen dhe mirëkuptimin e kryeministrit, ka shkruar Zemaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Hoti, që deri në përfundim të pandemisë punonjësve shëndetësorë t'u paguhet shtesa në të ardhura personale deri në 300 euro në muaj, bazuar në kategorizimin e bërë sipas rrezikshmërisë së drejtpërdrejtë nga virusi Covid-19. Kjo kërkesë ka gjetur mbështetjen dhe mirëkuptimin e kryeministrit, ka shkruar Zemaj në llogarinë e vet në "Facebook".

## Ramadani: Projektligji për pandeminë, i limituar

Drejtori i Institutit Kombëtar i Shëndetit Publik (IKShPK), Naser Ramadani, ka thënë se Projektligji për parandalimin dhe luftimin e pandemisë është dashur të procedohet më shpejt në Kuvend. Këto komente ai i ka bërë të hënën në Komisionin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, ku është mbajtur dëgjim publik

për Projektligjin për parandalimin dhe luftimin e pandemisë. "Është një ligj shumë i limituar sa i përket asaj që duam të arrijmë. Rekomandimet bazohen në dy koncepte. Shtylla e parë janë qytetarët, të cilëve ua kemi dhënë rekomandimet që konsistojnë në mbajtjen e maskës, higjienës dhe distancës. Nëse do të

realizoheshin në tërësi, ne do të ishim të stërkënaqur sepse pandemia do të zhdukej", ka thënë Ramadani. Ai ka folur edhe për respektimin e masave në fuqi kundër koronavirusit, të cilat, sipas tij, nëse do të respektoheshin, s'do të kishte nevojë për ndërhyrjen e policisë.

verifikuar të dhënat e prezantuara nga këto institucione me rastin e aplikimit dhe dhënies së Deklaratës nën betim për kushtet e plotësuara për kryerjen e testeve sipas Udhëzimit Administrativ 01/2020 për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ 09/2014 Kushtet

për punë sa i përket hapësirës, kuadrit profesional dhe pajisjeve mjekësore të institucioneve private shëndetësore jashtëspitalore dhe Udhëzimit Administrativ 02/2020 për plotësimin dhe ndryshimin e udhëzimit administrativ 06/2015 kushtet e përgjithshme dhe të veçanta spitalore.



Flet për “Epokën e re”, Belul Beqaj

# Zgjedhjet, më së larg



Politologu Belul Beqaj ka paralajmëruar se vendi mund të shkojë shumë shpejt në zgjedhje të reja. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ai ka thënë se ato do të mund të shkaktohen më së largu deri në vjeshtë të këtij viti. Sipas tij, vetëm qeveria e re do të mund ta vazhdojë dialogun për normalizim të marrëdhënieve Kosovë - Serbi. Beqaj ka deklaruar se qeveria Hoti ka qenë në kundërshtim me vullnetin politik të shumicës së qytetarëve të Kosovës. Ai e ka ftuar PDK-në që ta përkrahë mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë të cilin e ka iniciuar Lëvizja Vetëvendosje

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 10 GUSHT - Politologu Belul Beqaj ka bërë me dije se qeveria aktuale nuk do të jetë edhe shumë gjatë në pushtet. Ai ka deklaruar se zgjedhjet e reja do të mund të shkaktohen më së largu deri në vjeshtë të këtij viti. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, Beqaj ka thënë se vetëm qeveria e re do të mund ta vazhdojë procesin e dialogut Kosovë - Serbi. “Kjo qeveri do të kryejë rolin e ‘stafet mbajtjes’ deri

në zgjedhjet e lira që do të shkaktohen më së largu në vjeshtë, kur duhet të krijohet një qeveri legjitime dhe më mbështetje serioze të brendshme dhe ndërkombëtare. Qeveria e re do të angazhohet për zgjidhje të marrëveshjes me Serbinë brenda kufijve ekzistues duke gjetur kualitetin e ri mes shumicës dhe pakicës në Kosovë bazuar në të drejtat universale”, ka thënë Beqaj. Ai ka kritikuar punën e deritashme të qeverisë Hoti, sidomos në menaxhimin e pandemisë Covid-19. Sipas

Beqajt, kjo qeveri ka qenë në kundërshtim me vullnetin politik të shumicës së qytetarëve të Kosovës. “Motivi i kësaj qeverie ka qenë dhe është në kundërshtim me vullnetin politik të shumicës së qytetarëve të Kosovës, kështu që më mirë është koalicioni të prishet për shkak të kundërshtimeve të interesave të partnerëve sesa të rrezohet nga pakënaqësia popullore e cila ka arritur masën kritike. Qytetarët janë para katarsës së provokuar nga pushtetbërja që po e rrezikon seriozisht të sotmen dhe të

ardhmen”, është shprehur Beqaj. Në këtë intervistë Beqaj ka komentuar edhe mocionin e LV-së ndaj qeverisë. Sipas tij, ky mocion politikisht mund të arsyetohet. Beqaj ka vlerësuar se PDK-ja do të duhej ta përkrahte mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë. “Nëse PDK-ja nuk e sheh ‘malin prej drumit’ nuk do ta mbështetë mocionin, por nëse lidhshipi mendon për vizionin e partisë, atëherë ky do të ishte investim më serioz për të ardhmen e PDK-së, me kusht që në ndërkohë të kryhet një reformë e brendshme kadrovike kualitative duke ruajtur kontinuitetin e themeluesve por në duhmën e kërkesave të reja të rrethanave politike”, ka thënë Beqaj.

**“Epoka e re”:** Z. Beqaj, Lëvizja Vetëvendosje i ka nisur procedurat për mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë. Si e keni parë këtë iniciativë të partisë më të madhe opozitare?  
**Beqaj:** Ndoshta mund të

justifikohet politikisht mocioni i LV-së për mosbesimin e qeverisë Hoti, ngase mocioni i LDK-së ishte ndërmarrë në kohën kur menaxhimi i pandemisë nga qeveria Kurti ishte shembull jo vetëm për regjionin, ndërsa menaxhimi i pandemisë nga ky koalicion është shembull për dështimin e menaxhimit të pandemisë ngaqë vetëm për dy ditë kemi mbi 30 viktima, ndërsa për dy muaj rreth 200. Ndërsa për vendimet hakmarrëse për shkarkime në borde, për vonesat për rimëkëmbje të ekonomisë dhe për dialogun konspirativ jashtë kontekstit të rrethanave reale, të mos flasim.

**“Epoka e re”:** Partia tjetër opozitare, PDK-ja, ka kërkuar disa sqarime prej LV-së për ta përkrahur këtë mocion. Sa besoni në suksesin e këtij mocioni?

**Beqaj:** Nëse PDK-ja nuk e sheh “malin prej drumit” nuk do ta mbështetë mocionin, por nëse



# u në vjeshtë



leadershipi mendon për vizionin e partisë, atëherë ky do të ishte investim më serioz për të ardhmen e PDK-së, me kusht që në ndërkohë të kryhet një reformë e brendshme kadrovike kualitative, duke ruajtur kontinuitetin e themeluesve, por në duhmën e kërkesave të reja të rrethanave politike. Pra, PDK-ja s'ka nevojë të kërkojë sqarime nga LV-ja, por duhet t'ia sqaroj vetes se a dëshiron të jetë peng e së kaluarës apo sajuese e vizionit të së ardhmes.

**"Epoka e re":** Në anën tjetër, as partnerët e koalicionit nuk janë në harmoninë më të mirë. LDK-ja dhe AAK-ja për shumë çështje nuk po pajtohen. Cili është vlerësimi juaj për punën e deritashme të qeverisë Hoti?

**Beqaj:** Ne që e kemi përcjellë motivin e këtij koalicioni e kemi ditur se ky ishte koalicioni i një skenari të administratës amerikane të LDK-së i përbërë nga partnerët e interesave materiale. Realisht kjo qeveri do ta justifikonte veten nëse qysh nesër dorëhiqet, aq më parë kur skenari amerikan për dialogun me Serbinë, pas "pushimit" të kryenegociatorit (HTh), vetëm do ta "mbështesë" (Palmer) rolin "udhëheqës" (Borell) të BE-së, pavarësisht se unë mendoj se edhe kjo qasje është e gabueshme. Por, motivi i kësaj qeverie ka qenë dhe është në kundërshtim me vullnetin politik të shumicës së qytetarëve të Kosovës, kështu që më mirë është koalicioni të prishet për shkak të kundërshtimeve të interesave të partnerëve sesa të rrëzohet nga pakënaqësia popullore e cila ka

arritur masën kritike. Qytetarët janë para katarsës së provokuar nga pushtetbërja që po e rrezikon seriozisht të sotmen dhe të ardhmen.

**"Epoka e re":** Duke parë kundërtënie mes partnerëve të koalicionit dhe sfidat me të cilat po përballë Kosova, sa mund ta vazhdojë mandatin kjo qeveri, apo pritni zgjerim të koalicionit qeverisës?

**Beqaj:** Sa më shumë ta vazhdojë punën kjo qeveri aq më shumë do ta ngrehë pezmin e pakënaqësisë dhe revoltës qytetare e cila vetëm sa do të ashpërsohet nëse zgjerohet koalicioni qeverisës. Ana e mirë e kësaj zgjidhje të keqe do të ishte zhveshja e motiveve të partnerëve përfitues të cilët në zgjedhjet e radhës do të ndëshkohen nga votuesit.


**"Epoka e re":** Qeveria e ka rifilluar dialogun me Serbinë. Si prisni të vazhdojë ky dialog dhe cila duhet të jetë qasja e Kosovës në këtë proces?

**Beqaj:** Konteksti i rrethanave është shumë i disfavorshem. Kjo qeveri do ta kryejë rolin e "stafet mbajtjes" deri në zgjedhjet e lira që do të shkaktohen më së largu në vjeshtë, kur duhet të krijohet një qeveri legjitime dhe me mbështetje serioze të brendshme dhe ndërkombëtare. Qeveria e re do të angazhohet për zgjidhje të marrëveshjes me Serbinë brenda kufijve ekzistues duke gjetur kualitetin e ri mes shumicës dhe pakicës në Kosovë bazuar në të drejtat universale.

## Presidenti Thaçi krijon urdhrin 'Adem Demaçi'

PRISHTINË, 10 GUSHT (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka bërë me dije se ka vendosur ta krijojë urdhrin "Adem Demaçi", në nderim të përjetshëm të kontributit të veprimtarit të çështjes kombëtare, Adem Demaçit. Në profilin e vet në "Facebook", Thaçi ka shkruar se ky urdhër do t'u ndahet personaliteteve të vendit që shquhen për qëndresë dhe vetëdije të lartë kombëtare. "Jashtëzakonisht krenar që Kosova e pavarur është ndërtuar mbi themele të forta që janë vendosur nga

veprimtaria e atdhetarëve të shquar, siç është Adem Demaçi. Shteti ynë është shtëpi e gjeneratave të reja, që punojnë pandalshëm për t'i lartësuar vlerat që i besuam dhe për të cilat sakrifikuam shumë. Në nderim të përjetshëm të kontributit të pashembullt të Adem Demaçit, si president i vendit kam vendosur ta krijoj urdhrin 'Adem Demaçi'. Ky urdhër do t'u ndahet personaliteteve të vendit tonë që shquhen për qëndresë dhe vetëdije të lartë kombëtare", ka shkruar Thaçi.



## Molliqaj, Hysenit: Marrëveshja finale me Serbinë nuk mund të marrë formë pa ShBA-në

PRISHTINË, 10 GUSHT (ER) - Kryetari i Partisë Socialdemokrate (PSD), Dardan Molliqaj, është takuar të hënën me Skënder Hysenin, koordinator për dialogun Kosovë - Serbi. Me këtë rast Molliqaj ka thënë se marrëveshja përfundimtare me Serbinë nuk mund të marrë formë pa përfshirjen e ShBA-së. Sot jam takuar me z. Skënder Hyseni, koordinator për dialogun Kosovë - Serbi. Informimi dhe transparenca e procesit ka rëndësi të veçantë, prandaj dua ta falënderoj z. Hyseni për takimin. "Jemi pajtuar që marrëveshjet e pjesshme nuk janë rruga përpara. Kosova shkon në dialog për njohje reciproke.



Vazhdimi i procesit nuk ka kuptim nëse nuk e dimë qysh tash se epilogu është njohja e ndërsjellë. Ne jemi të bindur se një marrëveshje përfundimtare

me Serbinë nuk mund të marrë formë dhe garanc zbatimi pa përfshirjen e ShBA-së në këtë proces. Po ashtu, Kosova duhet të ketë kujdes që aranzhimet e

saj në marrëveshje të mos e thellojnë ndarjen etnike që tashmë ekziston me Listën Serbe. Kështu nuk zgjidhet, por përjetësohet problemi", ka shkruar Molliqaj në llogarinë e vet në "Facebook". Më tutje, Molliqaj ka thënë se janë të bindur se vazhdimi i status-quo nuk është në interes të vendit dhe qytetarëve. "Problemet e pakryera janë probleme edhe për të ardhmen. Për më tepër, aleancat politike, por edhe gjeopolitika e vitit '99 më nuk ekziston. Qëndrimet karshi dialogut ka kohë që nuk lidhen me procesin si i tillë, por me llogaritë e brendshme politike, respektivisht akuzat plot patos e hiq kritikë për

mbledhje votash. Guxim dhe progres sot përbën gatishmëria për të ecur drejt shkëputjes përfundimtare. Oportunitizëm është llogaritja elektorale dhe fshehja pas popullizmit të brendshëm. Vetëm shkëputja përfundimtare hap rrugë për një marrëdhënie të re midis popujve. Kjo shkëputje është historike jo thjesht sepse zgjidhet problemi Kosovë - Serbi. Popujt e Ballkanit do të jenë më të lirë kur problemet midis tyre të zgjidhen. Kështu i jepet fund gjeopolitikës së perandorive që ndërhyjnë në mënyrë jodemokratike pikërisht sepse gjejnë terren te problemet e hapura", ka shkruar Molliqaj.



## Osmani, komandantit të KFOR-it: Të shmangen situatat si ajo e Karaçevës

PRISHTINË, 10 GUSHT - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka takuar të hënën komandantin e KFOR-it, Michele Risi, me të cilin ka diskutuar për aspekte të sigurisë në vend dhe ndihmën që KFOR-i mund të japë në menaxhimin e pandemisë Covid-19. "Kryetarja Osmani u njoftua me gatishmërinë e strukturave të NATO-s, përkatësisht të misionit të saj në Kosovë, për t'u dalë në ndihmë qytetarëve dhe institucioneve të vendit në menaxhimin e pandemisë Covid-19", ka njoftuar Kuvendi i Kosovës. Sipas këtij njoftimi, gjeneral Risi ka shprehur gatishmërinë e strukturës që ai e udhëheq që KFOR-i t'i ofrojë të gjitha kapacitetet e nevojshme për ndihmë popullit dhe institucioneve të

Kosovës për menaxhimin e kësaj pandemie. Me gjeneral Risin, kryeparlamentarja Osmani ka diskutuar edhe për rolin e KFOR-it në ofrimin e sigurisë për qytetarët e vendit. "Kryetarja Osmani tha se si udhëheqëse e Kuvendit dhe përfaqësuese e popullit, e çmon jashtëzakonisht lart gatishmërinë e KFOR-it për të siguruar ambient të qetë dhe të sigurt, por kërkoi po kështu që bashkëpunimi i kësaj strukture ushtarake të thellohet me institucionet e sigurisë të Kosovës, në mënyrë që qytetarët e vendit të ndihen të sigurt dhe që të shmangen situatat sikur ajo e Karaçevës, të cilat mund të ndikojnë që qytetarët e vendit të mos ndihen të sigurt", ka njoftuar Kuvendi.



## Qytetarët të pakënaqur me shërbimet nga ARC-ja



PRISHTINË, 10 GUSHT - Para Agjencisë së Regjistrimit Civil (ARC) të hënën është krijuar një rend i gjatë i qytetarëve të cilët kanë pritje për t'i kryer shërbimet e tyre. Një gjë e tillë ka shkaktuar tollovi të madhe, duke bërë që mos të respektohet as distanca fizike ndërmjet tyre, e cila është paraparë si masë mbrojtëse nga Covid-19. Me këtë rast qytetarët kanë shprehur pakënaqësitë e tyre për mospërfilljen e kërkesave të tyre. Haxhi Nalli nga Krusha e Madhe ka thënë se është duke pritje para ARC-së për rreth një orë për shkak të rendit të gjatë të qytetarëve. Ai ka theksuar se para disa ditësh vullat postale janë dhënë në Prizren, mirëpo janë

ndërprerë dhe tashmë mund t'i marrin vetëm në Prishtinë. "Për shkak të numrit të madh të njerëzve po duhet të presim sepse vetëm në Prishtinë po duhet të vijë për vullë postale. Masat deri-diku po respektohen, por jo sa duhet", ka thënë Nalli.

Edhe Skender Haxholli nga Prishtina është i pakënaqur me shërbimin në Agjencinë së Regjistrimit Civil (ARC). Sipas tij, pritja për rreth një orë për një pasaportë është shumë e gjatë dhe e mundimshme. Kurse Idriz Gashi ka thënë se për një ndërrim të letërnjoftimit nuk duhet të krijohet rend i gjatë, duke shtuar se as masat nuk janë duke u respektuar sa duhet. /EO/

## Ministri Likaj dhe kryetari i SBASHK-ut bisedojnë për fillimin e vitit të ri shkollor

PRISHTINË, 10 GUSHT (ER) - Ministri i Arsimit dhe Shkencës (MASH), Ramë Likaj, ka pritje në takim kryetarin e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), Rrahman Jasharaj, me të cilin ka diskutuar lidhur me përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2020/2021 në ambientet shkollorë. Ministri Likaj në këtë takim ka folur për koncept-dokumentet të cilat janë hartuar për fillimvitin shkollor sipas rrethanave të krijuara nga pandemia Covid-19, ku secili vendim do të merret në konsultim të vazhdueshëm me Ministrinë e Shëndetësisë, IKShPK-në dhe

institucionet e tjera relevante. Ministri Likaj dhe kryetari Jasharaj janë pajtuar që të formohet një komision i përbashkët në mes të Ministrisë së Arsimit dhe SBASHK-ut për rishikimin e Kontratës Kolektive si dhe për mundësinë e vazhdimin të programit për ngritjen profesionale të mësimit, pa shpërndarje nga puna. Ndër të tjera, ministri Likaj është zotuar që të vazhdojnë përpjekjet e përbashkëta për të gjetur një zgjidhje të drejtë dhe ligjore për mësimit të cilët janë të prekur nga sëmundje të rënda.





# Deputetja Hoxha kërkon nga qeveria t'i krijojë kushtet për kthimin e fëmijëve në shkolla

Deputetja e PDK-së, Eliza Hoxha, ka kërkuar nga qeveria Hoti që, krahas menaxhimit të pandemisë Covid-19, t'i krijojë kushtet për kthimin e nxënësve në shkolla, kur kanë mbetur edhe pak javë nga fillimi i vitit të ri shkollor. "PDK-ja thekson se klasat mund të riorganizohen, e në rastet kur nuk ka mundësi për ta bërë një gjë të tillë, klasat mund të ndahen në dy grupe dhe mësimi të mbahet me orar të shkurtuar për të dy grupet e një klase", ka thënë Hoxha



EPOKA  
ERE **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 10 GUSHT (ER)** - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka shprehur shqetësimin në lidhje me mënyrën se si po menaxhohet pandemia Covid-19 nga ana Qeveria e Kosovës, duke kërkuar që, krahas menaxhimit të kësaj situatë, të krijohen kushtet për kthimin e nxënësve në shkolla.

Deputetja e PDK-së, Eliza Hoxha, ka thënë se shtatori po e gjen Kosovën dhe qeverinë e saj pa asnjë plan konkret se si do të vazhdojë mësimi për vitin 2020/2021. "Pushimeve verore edhe pak po u vjen fundi. Pandemia ka marrë dinamikë komplet tjetër në Kosovë pas hapjes së madhe, të pakontrolluar nga qershori, e nisja e mësimi në shtator e gjen Kosovën dhe qeverinë tjetër të saj pa një plan konkret se si do të vazhdojë mësimi për vitin 2020/2021. Mësimi online ishte domosdoshmëri jo vetëm në Kosovë, por kudo në botë kur u vendos për mbyllje totale apo karantinim në fillet e pandemisë, por sot kur jemi në një moment tjetër të sfidave të hapjes që shkaktuan natyrshëm edhe rritje të të infektuarve me Covid-19, prindërit dhe qeveritë e shumë vendeve përkundër kësaj, po apelojnë për hapjen e shkollave dhe kthimin e fëmijëve në kushte normaliteti

për shkak të shumë pasojave psikologjike, ngecjeve në zhvillim të fëmijëve dhe realizim të kurrikulës e, po ashtu, edhe në pabarazinë e madhe gjinore dhe etnike, që mësimi online e shpërfaqti kudo në botë, përfshirë këtu edhe Kosovën", ka thënë Hoxha në një konferencë për media të hënën.

Ajo ka theksuar se, sipas hulumtimeve dhe raportimit të fundit të ministrit të Arsimit, Ramë Likaj, para Komisionit Parlamentar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë, Rini e Sport, mbi 10 për qind e nxënësve kosovarë nuk kanë pasur fare qasje në mësimin online. "Po ashtu, kategoritë e tjera sociale dhe ato me fëmijë me nevoja të veçanta kanë pasur problematika të tjera gjatë kësaj periudhe për shkak të specifikave në të nxënët dhe punës me ta, si dhe mungesës së pajisjeve. Kur jemi te kategoritë e tjera etnike në Kosovë, p. sh., komuniteti RAE, po ashtu kishte probleme gjatë kësaj periudhe. Shifra arrin deri në 40 për qind të tyre që nuk kanë pasur qasje në mësimin online", ka thënë Hoxha, duke shtuar se PDK-ja ka analizuar politikat dhe strategjitë e vendeve të ndryshme në lidhje me mësimin në këtë kohë pandemie. "PDK-ja, duke analizuar politikat, strategjitë dhe qasjet e vendeve të ndryshme të cilat po

mobilizohen dhe përgatiten për rikthim në institucione, si dhe po ndër marrin masa që konform situatës së sigurisë shëndetësore, nivelit të rrezikut dhe kapaciteteve (infrastrukturore dhe të resurseve njerëzore). UNICEF-i, Banka Botërore dhe organizata të tjera ndërkombëtare e vendore, së bashku me qeveritë e vendeve të ndryshme dhe shkollat, po punojnë jo vetëm në rihapjen e shkollave, por në rihapjen e shkollave me kushte më të mira higjienike dhe organizative si një mjedis që do të garantojë mundësi të re për mësimin e drejtpërdrejtë. Po ashtu, masat si verifikimi i temperaturës, stacionet e larjes së duarve dhe dezinfektimit, mbajtja e maskës dhe distanca fizike do të jenë pjesë e jetës së përditshme në këto institucione", është shprehur ajo.

Më tutje, ajo ka thënë se pandemia ka shpërfaqur nevojën për norma të reja teknike hapësinore në institucionet publike. "Kësaj i shtohet më pas edhe shenjzimi dhe rekuizitat e tjera, të cilat patjetër do të jenë

pjesë e paletës së dizajnit të shkollave nëse mësimi do të mbahet në mjediset e saj. PDK-ja ngrë shqetësimin se a është Kosova gati për rikthim në shkolla sepse deri më sot nuk e kemi parë ndonjë plan konkret nga qeveria për fillimin e mësimi nëpër shkolla, as ide për riorganizim hapësinor të shkollave, shenjzimi apo edhe kushte higjienike, duke e ditur se shkollat tona edhe në kushte normale aspektin higjienik e kanë problematik. Skenarë të shumtë janë elaboruar nga praktikant ndërkombëtarë si rikthimi total - sidomos për klasat e ulëta ku më problematikja mbetet klasa e parë, rikthimi i kombinuar - disa orë në shkollë e disa në shtëpi apo skenari i tretë - mësimi online", ka thënë ajo duke shtuar se Ministria e Arsimit duhet që shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve ta vendosë në qendër të planeve rikuperuese nga Covid-19.

"PDK-ja thekson se mësimi online në kushte të izolimit total edhe e kishte kuptimin e vet pavarësisht cilësisë dhe problematikave që ka lënë pas, por tani që shumica e

aktiviteteve janë të hapura, prindërit duhet të punojnë jo vetëm për shkak të obligimeve, por edhe për shkak të rëndësës ekonomike të shkaktuar nga paaftësia e qeverisë Kurti dhe Hoti, të cilat dështuan rëndë në përkrahjen ekonomike të qytetarëve tash e gjashtë muaj andaj është absurde që ministri i Arsimit t'i kërkojë secilës familje që njëri prind të qëndrojë në shtëpi për shkak të mësimi online sepse fëmijët e vegjël e kanë të pamundur të jenë pjesë e tij pa mbikëqyrjen e prindit duke qenë se barra më e madhe u bie atyre. PDK-ja thekson se klasat mund të riorganizohen, e në rastet kur nuk ka mundësi për ta bërë një gjë të tillë, klasa mund të ndahet në dy grupe dhe mësimi të mbahet me orar të shkurtuar për të dyja grupet e një klase. Shenjzimi dhe pajisjet higjienike shtesë janë të domosdoshme për hapësirat publike. Tashmë edhe këto shërbime, siç e dimë, zakonisht tenderohen në bazë të ligjit të prokurimit dhe marrin kohën e vet. A ka kohë mjaftueshëm për këto procese deri më 1 shtator?", ka pyetur deputetja e PDK-së, Eliza Hoxha.



## LV-ja fton në interpelancë ministrin e Arsimit

**PRISHTINË, 10 GUSHT (ER)** - Grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosjeje ka iniciuar interpelancë parlamentare për ministrin e Arsimit dhe Shkencës, Ramë Likaj. Në njoftimin e LV-së të publikuar në "Facebook", kjo parti politike ka bërë me dije se interpelanca ka të bëjë me gjendjen në sistemin e arsimit, planet dhe përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor. "Sot grupi parla-

mentar i Lëvizjes Vetëvendosjeje ka dorëzuar kërkesën për interpelancë ndaj ministrit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në lidhje me gjendjen në sistemin e arsimit, planet dhe përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor. Pavarësisht se vetëm edhe tri javë na ndajnë nga kur do të fillojë viti shkollor dhe akademik, kjo ministri nuk ka ndërmarrë thaujse asgjë për fillimin e vitit

shkollor. Jemi tashmë shumë vonë me planifikim për fillimin e vitit shkollor. Ministria e Arsimit dhe Shkencës nuk ka paraqitur ndonjë plan dhe strategji për ta garantuar realizimin e procesit mësimor, përfshirjen e të gjithë nxënësve në proces, si dhe mënyrën e zhvillimit të procesit mësimor në situatën në të cilën ndodhet vendi me Covid-19", është thënë në njoftimin e LV-së.



# Miratohet marrëveshja e huas ndërmjet Kosovës dhe BE-së në vlerë prej 100 milionë eurove

Qeveria Hoti ka miratuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Bashkimit Evropian (BE) dhe Kosovës për ndihmën makro-financiare për Kosovën e cila marrëveshje do të procedohet për miratim në Kuvend. Me këtë projektligj, Kosova pritet të marrë nga BE-ja 100 milionë euro në formë të huas

**EPOKA E RE****A. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 10 GUSHT** - Qeveria e Republikës së Kosovës, e drejtuar nga kryeministri Avdullah Hoti, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë, ka mbajtur mbledhje korresponduese (mbledhje elektronike), në të cilën ka miratuar Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës për ndihmën makro-financiare për Kosovën.

“Marrëveshja e huas ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës për ndihmën makro-financiare për Kosovën është e nënshkruar më 30 korrik 2020.

Me miratimin e projektligjit për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje, e cili do të procedohet për miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës, do të fillojë realizimi i ndihmës makro-financiare për Republikën e Kosovës në shumën maksimale prej 100 milionë eurosh në formë të huas. Kjo ndihmë është aprovuar edhe në Parlamentin Evropian dhe në Këshillin e Evropës pas kërkesës së Qeverisë së Kosovës për ndihmë makro-financiare nga Bashkimi Evropian në lidhjen me pandeminë Covid-19 në prill të këtij viti”, është thënë në njoftimin e Qeverisë së Kosovës.

## Trusti: Jemi në pritje të ndryshimeve ligjore për tërheqjen e 10 për qind të mjeteve



**PRISHTINË, 10 GUSHT** - Në Kuvendin e Kosovës ende nuk është miratuar ndryshimi ligjor me anë të të cilit do t'u mundësohej kontribut-paguesve tërheqja e 10 për qind të kursimeve të tyre. Lidhur me këtë janë deklaruar nga Trusti Pensional, duke thënë se janë në pritje të ndryshimit të ligjit për të vazhduar më pas me procedura të mëtutjeshme. “Trusti është duke pritur miratimin e ndryshimeve ligjore në Kuvendin e Kosovës që do t'u mundësonin kontribuesve aplikimin për tërheqjen e 10-përqindëshit. Deri më tani Kuvendi nuk e ka diskutuar ndryshimin e Ligjit për Fondet Pensionale në Kosovë.

Kujtojmë këtu se edhe nëse miratohen ndryshimet ligjore nga Kuvendi, Trusti është i obliguar të presë derisa ligji të hyjë në fuqi (nënshkrimin e ligjit nga Presidenti dhe publikimin në Gazetën Zyrtare)”, është thënë në njoftimin e Trustit, duke shtuar se aktualisht Trusti është duke punuar për përgatitjen e infrastrukturës që do ta mundësonte realizimin e aplikimit përmes internetit për tërheqjen e 10 përqindëshit. “Kontribuesit do të njoftohen me kohë për të gjitha detajet dhe për fillimin e këtij procesi”, është thënë në fund të njoftimit të Trustit Pensional të Kosovës.

**(A. MAVRAJ)**

## Hoti i jep mbështetje Telekomit të Kosovës

Prishtinë, 10 gusht - Kryeministri i vendit, Avdullah Hoti, ka thënë të hënën se Telekomit do ta ketë mbështetjen e Qeverisë së Kosovës. Hoti në një postim në profilin e vet në “Facebook” ka shkruar se bashkë me ministrin e Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, ka zhvilluar një

takim virtual me anëtarët e Bordit të Telekomit. “Telekomi do ta ketë mbështetjen e Qeverisë së Kosovës. Bashkë me ministrin e Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, sot kemi zhvilluar takim virtual me anëtarët e bordit të Telekomit, me të cilët biseduam për gjendjen e

përgjithshme në këtë ndërmarrje. Qeveria e Kosovës, si akcionare, do ta mbështesë këtë ndërmarrje me interes strategjik për vendin dhe shumë shpejt do të diskutohet edhe plani për rimëkëmbjen i cili është duke u përgatitur nga Bordi i Telekomit”, ka shkruar Hoti.





# Përfaqësuesit e bizneseve diskutojnë me ministrin Kuçi për rimëkëmbjen ekonomike

Nëpërmjet konferencës virtuale, në takim me ministrin e Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, kreu i Odës Ekonomike Amerikane, Arian Zeka, ka bërë thirrje për përsheptimin e procedurave për miratimin e projektligjeve të cilat sigurojnë mbështetje ndaj sektorit privat. Ai ka theksuar se anëtarët e Odës Amerikane në mënyrë konstante kanë dhënë rekomandime për Qeverinë e Kosovës në mënyrë që ajo t'i dalë në ndihmë ekonomisë së vendit në këtë situatë krize



OEEK-ut, Arian Zeka, ka bërë thirrje për përsheptim të procedurave për miratimin e projektligjeve të cilat sigurojnë mbështetje ndaj sektorit privat, derisa ka theksuar se anëtarët e Odës Amerikane në mënyrë konstante kanë dhënë rekomandime për qeverinë në mënyrë që ajo t'i dalë në ndihmë ekonomisë së vendit në këtë situatë krize. Sipas OAK-ut, gjatë kësaj konference përfaqësuesit e ndërmarrjeve anëtare të Odës Amerikane si dhe kryesuesit e komiteteve të ndryshme brenda kësaj ode, kanë pasur mundësi të ofronin një pasqyrë më të hollësishme mbi ndikimet që pandemia Covid-19 ka pasur mbi veprimtaritë e tyre, por edhe rekomandime mbi mbështetjen për të cilën ka nevojë sektori privat. Ndërmarrësi Ardian Hoxha, kryesues i Komitetit të Ekonomisë Digjitale të Odës Amerikane, ka thënë se Kosovës i duhen investime të mëçuara në sektorin e teknologjisë informative dhe komunikimit, i cili, sipas tij, ka potencialin më të madh për rritje, por pengohet nga barrierat më bazike, duke përmendur nevojën urgjente për ta shtyrë përpara Projektligjin për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara në transaksionet elektronike. Ndërsa Avni Krasniqi nga kom-


**EPOKA ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 10 GUSHT** - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEA) ka organizuar një konferencë virtuale me ministrin e Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, në të cilën është diskutuar për rimëkëmbjen e ekonomisë së vendit si dhe mundësitë e qeverisë për përkrahjen e sektorit privat. Në këtë konferencë ministri Kuçi ka folur për strategjitë dhe arritjen e rimëkëmbjes së mirëfilltë ekonomike, mbështetjen e qeverisë për ndërmarrjet private të të gjithë sektorëve, si dhe ndryshimet e nevojshme në aspektin ligjor për ta mundësuar implementimin e masave për rimëkëmbje. Kuçi ka theksuar se puna e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit bazohet në planprogramin për reformë ekonomike 2020-2023, ndërsa përmban edhe në të masa të destinuar për rimëkëmbje ekonomike, përmes të cilave synohet t'u

ofrohet mbështetje të gjitha ndërmarrjeve private të goditura nga kriza e shkaktuar pas shpërthimit të pandemisë. Sipas Kuçit, projektligji për masat e përkohshme për ta lehtësuar efektin e pandemisë Covid-19 përfshin lehtësimin për qasje në financa, zvogëlimin e barrës tatimore, mbështetjen e punësimit, subvencionimin e pagave të punëtorëve në sektorin privat, si dhe stimulimin e përgjithshëm të kërkesës agregate. "Duke e marrë parasysh ndikimin e pandemisë Covid-19, investimet kapitale të parapara për këtë vit janë përgjysmuar në mënyrë që të krijohen fondet e nevojshme për rimëkëmbje", ka thënë Kuçi. Ai ka thënë se, pavarësisht prej zhvillimeve të fundit politike në Kosovë, qeveria mbetet e fokusuar për implementimin e masave për rimëkëmbje ekonomike, kurse ka thënë se strategjitë e përdorura janë në koordinim me mekanizmat dhe praktikat e institucioneve ndërkombëtare. Ndërsa drejtori ekzekutiv i

pania "Delfin", njëherësh kryesues i Komitetit të Tregtisë dhe Doganave të Odës Amerikane, ka potencuar se është e domosdoshme të bëhet zbatim sa më i shpejtë i masave në ndihmë të sektorit privat, në mënyrë që të evitohet humbja e mëtuajshme e vendeve të punës. Milazim Abazi nga "BDO Kosova", kryesues i Komitetit të Financave të Odës Amerikane, është shprehur se qeveria duhet ta përkrahë fuqishëm sektorin privat dhe ta lehtësojë rrugën për implementim të projekteve dhe dhënie të granteve nga institucionet ndërkombëtare financiare në Kosovë.

## Abrashi shkarkoi 'njësitë zbatuese të projekteve' në Ministrinë e Infrastrukturës



**PRISHTINË, 10 GUSHT (ER)** - Ministri i Infrastrukturës (MI), Arban Abrashi, bazuar në rekomandimet e Zyrës Kombëtare të Auditorit (ZKA), ka marrë vendim për shkarkimin e "njësive zbatuese të projekteve" për shkak se gjatë themelimit të tyre ishin anashkalluar kërkesat ligjore. Raporti i Auditorit ka gjetur se

vendimet për themelimin e njësive për mbikëqyrjen e projekteve, "Ndërtimi i autostradës Kijevë-Zahaq", "Ndërtimi i autostradës Prishtinë-Gjilan-Dheu i Bardhë", "Zgjerimi i hyrjedaljeve në Ferizaj, Prizren dhe Gjilan", zhvillimi i projektit të Autostradës Istog-Pejë-Deçan, Gjakovë, Prizren", janë marrë pa

miratimin paraprak të Ministrisë së Financave, e cila kërkohet sipas ligjit. Sipas ZKAs, themelimi i këtyre njësive, duke mos iu përmbytur kërkesave rregullative, mund të ndikojë në shpenzime të parregullta të buxhetit si dhe mangësi në menaxhimin financiar. Andaj ministri Abrashi ka vepruar në zbatim të

ligjshmërisë, duke u bazuar në të gjeturat e Zyrës Kombëtare të Auditorit, duke shfuqizuar vendimet paraprake në mënyrë që të futet në binar ligjor i gjithë ky proces. Po ashtu, ministri në ditët e ardhshme do të nxjerrë edhe vendime të tjera, që kanë dalë si rekomandime të Auditorit, për ta kursyuar paratë publike dhe për ta zbatuar ligjin.

## Nis ekzekutimi i pakos emergjente i masës 15, përfitojnë mbi 27 mijë familje

**PRISHTINË, 10 GUSHT** - Ministria e Financave, Hykmete Bajrami, ka bërë me dije se ka filluar ekzekutimi i transferit për pagesën e masës 15 të pakos emergjente fiskale për 27 572 familje. Bajrami ka thënë se këto mjete mund të tërhiqen nga e dita e mërkurë. "Ministria e Financave

njofton se Thesari sapo ka urdhëruar transferin për pagesën e 27 572 familjeve përfituese të masës 15 për muajin maj dhe qershor njëkohësisht, duke përfunduar në këtë mënyrë ekzekutimin e plotë të masës 15, ndërsa ankesat eventuale do të trajtohen me prioritet nga organi kompetent. Tërheqja

e mjeteve mund të bëhet nga data 12 gusht (e mërkurë) për shkak të aspekteve operationale ashtu që mjetet të tërhiqen nëpër zyra postare sa më afër vendbanimit tuaj dhe, gjithashtu, në respektim të udhëzimeve të institucioneve shëndetësore", ka shkruar Bajrami në llogarinë e vet në "Facebook".





# Gjilani shpall konkurs për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë

**GJILAN, 10 GUSHT (ER)** - Drejtoria e Arsimit në Gjilan ka shpallur konkursin për regjistrim të nxënësve në klasën e parë në të gjitha shkollat fillore. Drejtori i kësaj drejtorie, Nazim Gagica, ka thënë se regjistrimi i fëmijëve në klasë të parë do të zgjasë deri në shtator 2020. "Në klasën e parë të shkollave fillore të Komunës së Gjilanit, për vitin shkollor 2020/21, mund të regjistrohen fëmijët të cilët i mbushin moshën minimale gjashtëvjeçare. Fëmijët të cilët nuk i kanë ende gjashtë vjet mund të regjistrohen, por duke i plotësuar kushtet e parapara sipas UA 16-2004, neni 2, pika

2.1 (fëmijët mund të regjistrohen pa i mbushur 6 vjet, por me vlerësimin e mjekut dhe psikologut), pastaj vendimin e merr DKA", ka thënë Gagica. Për regjistrimin në klasën e parë në arsimin e detyrueshëm, fëmijët duhet ta paraqesin ekstraktin e lindjes. Regjistrimi i fëmijëve në klasën e parë fillon prej datës 10.08.2020, në lokalet e shkollave përkatëse, duke filluar nga ora 8:00 deri 16:00. Pas mbylljes së afatit për regjistrimin e fëmijëve në klasën e parë, drejtoria e shkollës përkatëse do ta bëjë shpërndarjen e fëmijëve në paralele.



## Komuna e Malishevës vazhdon t'i ofrojë shërbimet normalisht



**MALISHEVË, 10 GUSHT (ER)** - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka mbajtur mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, ku drejtorët e drejtorive kanë raportuar për punët dhe aktivitetet e tyre gjatë javës së kaluar dhe planifikimet për javën në vijim. Në këtë mbledhje është bërë me dije se puna në administratën komunale është duke u kryer me staf të reduktuar për shkak të situatës pandemike, mirëpo të gjitha shërbimet komunale janë duke u kryer pa probleme dhe deri më tani nuk ka ankesa në kryerjen e shërbimeve. Po ashtu, është bërë me dije se është duke vazhduar implementimi i planifikimeve për këtë vit, përfshirë edhe

investimet apo realizimin e projekteve kapitale, edhe pse shumë prej tyre kanë filluar me vonesë për shkak të situatës me pandeminë Covid-19. Sa i përket situatës pandemike, është theksuar se situata vazhdon të jetë e nën kontroll, pavarësisht prej rasteve dhe se shërbimet komunale përgjegjëse janë duke ofruar mbështetjen e nevojshme në të gjitha rastet, si në ofrimin e shërbimeve shëndetësore, ashtu edhe me shërbimet e tjera, përfshirë edhe furnizimet. Me këtë rast, kryetari i Malishevës, Ragip Begaj, ka kërkuar nga të gjitha drejtoritë që të vazhdojnë të punojnë, pavarësisht situatës dhe t'i kryejnë të gjitha obligimet që kanë.



## Fillon asfaltimi i rrugicave në fshatin Miradi e Epërme

**FUSHË-KOSOVË, 10 GUSHT (ER)** - Komuna e Fushë-Kosovës është duke vazhduar t'i realizojë projektet e planifikuara të cilat janë në shërbim të mirë të qytetarëve të saj, duke treguar kështu

përkushtimin dhe seriozitetin në përmbyshjen e të gjitha projekteve të premtuara. Në kuadër të këtyre projekteve të planifikuara, të hënën ka filluar asfaltimi i rrugicave në fshatin Miradi e Epërme.



## Nesër hapen të gjitha çerdhet publike e private në Ferizaj

**FERIZAJ, 10 GUSHT (ER)** - Komuna e Ferizajt, përkatësisht Drejtoria e Arsimit, pas bartjes së kompetencës nga niveli qendror në komuna, për hapjen e çerdheve publike e private,

përkitazi me situatën e pandemisë Covid-19, ka marrë vendim që nga nesër (e mërkurë) të hapen të gjitha çerdhet publike dhe private në Ferizaj. Kjo komunë ka njoftuar

se funksionimi i çerdheve do të bëhet sipas protokollit të veçantë që do t'i komunikohet institucioneve parashkollore nga Drejtoria e Arsimit për mbrojtje nga virusi Covid-19.



# UÇK-ja SI FORCË E LIRISË SHPËTOI NJË KOMB PREJ GODITJEVE TERRORISTE SERBE (28)



**Shkruan: Kudusi LAMA**

Këtë vlerësim e gjejmë më të hollësishëm te raporti i zotëri Martyt, i cili ka zbuluar se akoma shqiptarët vazhdojnë t'i zbatojnë rregullat kanunore të mafisë, se ku i ka mësuar zotëri Marty këto unë nuk e di, por një gjë e di mirë, që shqiptarët nuk kanë asnjë kod mafioz, përveç kodit kulturor, me të cilin krenohen ndërmjet kombeve të tjera. E për sa iu përket serbëve, nuk duhet pretenduar shumë sepse është plotësisht e sigurt se kodin e kulturës dhe të humanizmit nuk i njohin.

"Shqiptarët e pasur dhe të shquar në vendet e Evropës Perëndimore dhe të ShBA-së, krahas mbështetjes financiare, janë përpjekur që UÇK-në ta paraqesin si lëvizje kombëtare, kurse aksionet terroriste të saj si luftën çlirimtare të popullit shqiptar në Kosovë - Metohi, që në një masë të rëndësishme, e kanë arritur. Në këtë plan kanë krijuar pikëmbështetje te një pjesë e politikanëve dhe të diplomatëve perëndimorë".<sup>1</sup>

Shikoni sa të pakorrigjueshëm janë serbët dhe Serbia në tërësi. Megjithatë u ngrit në këmbë një botë e tërë, megjithatë u bë një luftë, ku përveç luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës u angazhuan edhe forcat ajrore të NATO-s, si forca politiko-ushtarake më e madhe, më e fortë dhe më moderne e kohës, megjithatë u nënshkrua një marrëveshje kapitullimi pa kushte më 9 qershor 1999 në Kumanovë, ata vazhdojnë ta quajnë UÇK-në organizatë terroriste. Dhe politikën botërore që e mbështeti si të mashtruar prej disa të pasurve shqiptarë, që siç duket i paskan korruptuar presidentin e ShBA-së, kancelarin e Gjermanisë, presidentin e Francës, kryeministrin e Mbretërisë së Bashkuar, sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, komandantin e forcave ushtarake të NATO-s etj. Nuk di vërtetë ku e gjejnë gjithë këtë guxim Serbia dhe Dick Marty që të paragjykojnë gjithë spektrin politik dhe ushtarak më modern e më të fuqishëm të kohës. Por një gjë dihet mirë, që ato forca erdhën në Kosovë,

jo për t'u bërë pjesë e një "organizatë terroriste" siç e quani ju UÇK-në, por për të bashkuar forcat me UÇK-në si forcë e lirisë, për të shpëtuar një komb të tërë prej goditjeve terroriste serbe, që tentonin ta likuidonin tërësisht si komb.

"Në Konferencën e 18 islamike të organizuar në Pakistan, në tetor 1998 separatizmi shqiptar në Kosovë u karakterizua si xhihad, me të cilin tërë bota myslimane është ftuar ta ndihmojë, me të gjitha mjetet disponuese, luftën "për çlirim në territoret myslimane të pushtuara. Duke u thirrur në xhihad, organizata terroriste e Osama Bin Ladenit ka lajmëruar për sulme terroriste kundër "të pabesëve", përkatësisht të Britanisë së Madhe, ShBA, Francë dhe Serbisë".<sup>2</sup>

Tani edhe Serbia është vënë përballë Alkaedës se paska pushtuar Kosovën, dhe qenka rreshtuar me SHBA-të, Francën e Anglinë, sikur deri tani nuk ishte Serbia që këto shtete të nderuara i quajti bashkëpunëtorë të terrorizmit shqiptar. Por edhe sikur të jetë e vërtetë kjo, ç'lidhje ka UÇK-ja me Alkaedën? Se çfarë thuhet në vendet islame, pse duhet të hidhen gur mbi shqiptarët? A edhe në pikëpamje fetare shqiptarët u bëjnë shumë hije serbëve? Ne nuk jemi marrë kurrë me fenë e tyre, vetëm feja e tyre është marrë me shqiptarët pa ndërprerje, ka hedhur gurë pa ndalur dhe ne prapë nuk jemi marrë kurrë me fenë, sepse konsiderojmë se feja nuk ka për detyrë të bëjë agresion, siç bën pa ndërprerje kisha serbe kundër shqiptarëve.

"Për praninë e islamit radikal në Kosovë - Metohi flet e dhëna se gjatë vitit 1995, Osama Bin Laden qëndroi në Shqipëri si mysafir i presidentit të atëhershëm Sali Berisha, kur u formuan bazat për mbështetjen logjistike e financiare ndaj organizatës së Al Kaedes dhe u vendosën selitë e saj në krahinën e Kosovës - Metohisë. Krahas BinLadenit, në takimin e lartpërmendur asistuan Bashkim Gazidedja, ish shefi i policisë sekrete të Shqipërisë, Hashim Thaçi dhe Ramush Haradinaj. Me këtë rast, Bashkim Gazidedja u zgjodh si një nga udhëheqësit e Alkaedës për krahinën e Ballkanit".<sup>3</sup> Sa interesant është ky "fakt" i dhënë nga Serbia se Hashim Thaçi dhe Ramush Haradinaj

janë takuar edhe me Osama Bin Ladenin. Kjo është një e dhënë që i shërben shumë zotëri Martyt, a mos i ka kaluar pa e parë, apo serbët janë bërë pishman pse e kanë thënë? Se në raportin e zotit Marty në emër të Evropës ky "fakt" nuk është. Jo, nuk kishte punë Osama Bin Ladeni në Kosovë, se ai nuk është shqiptar. Ne në Kosovë kemi pasur vetëm shqiptar, të cilët emërtoni si të doni ju, por ata e kanë kryer më së miri detyrën e tyre ndaj



atdheut e kombit.

"Luftëtarët fanatik islam nga Afganistani, Algjeria, Egjipti, Çeçenia, Irani dhe vende të tjera ishin përfshirë në përbërjet komanduese të shtabeve të UÇK-së në Kosovë - Metohi. Në raste të caktuara këta persona të orientuar radikalisht dhe të stërvitur lart profesionalisht formuan reparte të pavarura të angazhuara në detyra luftarake dhe taktike speciale. Morën pjesë drejtpërdrejtë në pushtimin dhe spastrimin e terrenit, në arratisjen e qytetarëve dhe të pjesëtarëve të policisë, në torturat dhe likuidimet e ashpra. Gjithashtu kanë qenë të angazhuara edhe si instruktorë të stërvitjes speciale të disa formacioneve të UÇK-së. Në vitin 1998 Departamenti i shtetit e vuri UÇK-në në listën e organizatave terroriste, duke vërejtur se operacionet e saj financohen me para nga tregtia ndërkombëtare e heroinës dhe me huatë vendeve islamike dhe të individëve midis të cilëve ka qenë, edhe Osama Bin Laden. Sipas citimeve të specialistëve nga Interpoli, lidhja tjetër me Bin Ladenin është fakti që Muhamed al Zavahiri, vëllai i dr. AjmanZavahirit, lideri i organizatës xhihadiegjyptian dhe i ideologut AlKaida,

udhëhoqi repartin elite të UÇK-së gjatë kohës së konfliktit në Kosovë - Metohi".<sup>4</sup>

Është e vërtetë që në vitet 1997 - 1998 ju shpifët siç edhe vazhdoni me të gjitha mënyrat e mjetet që të bindnit perëndimin dhe ShBA-të se UÇK-ja ishte një organizatë terroriste, islamike, komuniste, etj., por perëndimi dhe SHBA-të nuk ranë në kurthin tuaj. Ato e kuptuan mirë se ai nuk ishte tjetër veçse një kurth serb dhe

gjakun e tyre të pastër për interesat e lirisë së atdheut të tyre tek i cili kishin rrënjët e do të ndërtonin të ardhmen. Por ju ashtu do t'i quani, se nuk keni besuar kurrë se shqiptarët do të kenë fuqinë t'iu zhdukun njëherë e përgjithmonë prej Kosove. Ju pikërisht për këtë edhe sot e kësaj dite nuk keni guximin të deklaroni se sa ushtarë janë vrarë në Kosovë gjatë luftës çlirimtare të Kosovës, pasi nuk doni të pranoni se edhe ju mund të vriteni nga arma shqiptare. Ka shumë mundësi që të keni humbur edhe varret e ushtarëve tuaj, vetëm për të mos pranuar se janë vrarë në Kosovë. Por të jeni të sigurt, në mos sot, nesër vetë ushtarët e mbetur gjallë do të tregojnë për kolegët e tyre dhe do të befasoheni se çfarë kanë përjetuar ata në përlëshje me luftëtarët e UÇK-së që sidoqoftë kanë qenë të gjithë shqiptarë.

"Numri më i madh i pjesëtarëve të repartit "Abu Bekir Sidik", i kombësisë shqiptare, pas vendimit që reparti të shkrihej, u kthyen në vendet e veta të banimit në Kosovë - Metohi, ndërsa grupi i dytë u përpoq të kalonte në territorin e Shqipërisë. Me këtë rast në gusht të vitit 1998, nga ana e organeve të sigurimit të Republikës së Serbisë burgosen Ekrem Avdia, Shpend Kopriva dhe Nexhmedin Llausha dhe pastaj edhe pjesëtarët e tjerë të repartit muxhahedin".<sup>6</sup>

Ju vërtet mund të keni burgosur shqiptarë por, megjithatë, siç edhe i deklaroni emrat e të arrestuarve, ata paskan qenë të gjithë shqiptarë e jo muxhahedinë siç pretendoni. Pra, ata nuk qenkan as arabë, as egjiptianë e as indianë por, thjesht, shqiptarë. Ama se çfarë emërtimi u vini ju, kjo është puna juaj. Me rëndësi është që sado të shpifni, vetë ju një ditë do ta tregoni të vërtetën e do t'ju vijë turp prej gënjeshtres tuaj. Populli shqiptar ka një fjalë të urtë që thotë: "Gënjeshtria i ka këmbët e shkurtra". Aq do t'i ketë edhe gënjeshtria juaj. Të shkurtra. (Vijon me datën 18 Gusht 2020)

<sup>1</sup> Obiliç, Millosh, "Engjëjt e zinj të skëterrës kosovare", "dosjet sekrete", Beograd, 2004, faqe 49, botimi serbisht

<sup>2</sup> Po aty faqe 49

<sup>3</sup> Po aty faqe 49

<sup>4</sup> Po aty faqe 50

<sup>5</sup> Po aty faqe 50-51

<sup>6</sup> Po aty faqe 51



# Kosova dhe Kroacia e kishin armikun e përbashkët



Shkruan: Ylber Çitaku

Dëshmorë dhe martirë, gjeneralë dhe komandantë, ushtarë çlirimtarë, keni bërë transformim, e çliruat vendin, apo jeni “cuba primitivë”?! Këto ditë kur po lexoja për përvjetorin e çlirimit të Kroacisë, konkretisht të ofensivës “Oluja” (Stuhia), leximin po e përcillja duke dëgjuar këngët e këngëtarit dhe luftëtarit patriot kroat Marko Perković Thomson, në ndërkohë nuk ke si të mos jesh i emocionuar kur sheh burra e gra, pleq e të rinj që dynden në secilin përvjetor nëpër sheshet e qyteteve kroate për ta festuar lirinë dhe pavarësinë e vendit të tyre. Nuk jam i sigurt prej nga buron simpatia ime ndaj popullit kroat. Ka mundësi që ajo derivon nga zhvillimet, përkatësisht luftërat e fundshekullit të kaluar dhe nga bindja ime se kroatët janë patriotë. Televizione publike e private kroate, gazeta e portale të këtij vendi, fytyra publike e qeveritare, madje edhe zëvendësministra nga komuniteti serb flasin me pietet për luftën e Ushtrisë kroate, flasin me admirim për luftëtarët, qofshin ata të huaj apo kroatë. Mjafton që ata të kenë qenë të rreshtuar në anën e së drejtës kroate. Ndërsa te ne, emocionet përzihen nga prishen në momentin kur njeriu hap portalet e vendit tonë dhe rrytetet sociale, nëpër të cilët tashmë është bërë e pamundur që të kalojë java e të mos hasësh në staturë, artikuj ose deklarata të njerëzve prej profileve dhe profesioneve prej më të ndryshmeve, e të mos lexosh a dëgjosh qëndrime prej talljes, cinizmit e deri te deklarimet e hapura me urrejtje ndaj çlirimtarëve dhe vet, përkatësisht ndaj UÇK-së, në përgjithësi. Në këtë rast është e tepërt të shtrohet pyetja kush janë këta që shkruajnë e flasin. Kjo pyetje mund të bëhet vetëm sa për t’u futur në temë, sepse opinioni i gjerë tashmë e ka kuptuar se ata nuk janë numra simbolikë, ata nuk janë njerëz që kanë “rrjedhë” mendërisht, përkundrazi ata dinë çfarë bëjnë dhe për kë punojnë. Opinioni i gjerë publik tashmë e di që ata



janë njerëz që e kanë në pronësi dhe menaxhim një faqe të “Facebook”-ut, janë njerëz nga bota akademike, janë pronarë gazetash e televizioneve, janë pjesë e kabineteve qeveritare, janë e çfarë nuk janë, por që të gjithë e kanë një të përbashkët në mendjen e tyre – urrejtjen patologjike ndaj UÇK-së. Që nga paslufta e Kosovës vazhdimisht ka pasur zëra që me cinizëm e përbuzje kanë folur për UÇK-në, e të njëjtit me simpati e dashuri kanë folur për kohën e Jugosllavisë, gjithnjë duke u munduar që atë nostalgji ta shprehin nëpërmjet figurave të ndryshme të kohës, si ish-politikanë, sportistë, artistë, gazetarë, e deri te “bukuritë” e natyrës e të qyteteve. Duke mos dashur të shkojmë larg në kohë, vetëm brenda intervalit kohor prej një viti kemi pasur individë nga bota akademike, anëtarë të kabineteve qeveritare, pronarë gazetash e televizioneve, fëmijë të baballarëve që i shërbyen me devotshmëri sistemit jugosllav, të njëjtit pa fije turpi (sepse për frikë më as që flitet) hedhin vrer mbi UÇK-në dhe mbi njerëzit që ishin pjesë e këtij formacioni të lavdishëm ushtarak. Brenda harkut kohor prej një viti e kemi intervistën e një publicisti që në hapësirat mbarëshqiptare e ka një reputacion me nam, i cili në stilin e tij “qesh e ngjesh” qesh e përqesh shqiptarët deri në përmasat e asaj sa çlirimin e vendit e quan transformim, kurse çlirimtarët i quan cuba primitivë. Shih çudinë, asnjëri nga liderët politikë, asnjëri nga komandantët e zonave nuk doli kundër një qëndrimi të tillë, e pak kohë më vonë që të gjithë si në kor iu kundërvunë ish-këshilltarit të ish-kryeministrit për një deklaratë që në aspektin përmbajtësor ka qenë më e “butë” në raport me çlirimtarët dhe me UÇK-në. Është për keqardhje se si edhe liderët e partive politike që njihen si krah i luftës, kanë rënë pre e këtyre njerëzve dhe opinioneve të tyre, e si rezultat i kësaj këta liderë politikë e ushtarakë tani mbajnë afër vetes një numër krejt simbolik të bashkëluftëtarëve të tyre, të cilët i mbajnë aty vetëm sa për sy e faqe, kurse për ushtarët e vijave të para të frontit të luftës as që dinë. Këta liderë e këta komandantë rrethohen nga shpura e njerëzve që luajnë role të sekserëve, sahanlëpirësve e servilëve, gjithsesi pjesëtarëve të shpurës hallall u qoftë pasi kanë arritur që këta liderë e këta komandantë t’i izolojnë nga ata

që në kohët më të vështira e më të lavdishme, jo vetëm që u qëndruan afër, por ishin në gjendje ta japin edhe jetën, vetëm e vetëm të mbrohet territoret, popullata, bazat dhe qëndrimet e tyre. Për t’i ndërlidhur shkrimet dhe deklarimet në fjalë (kroate & kosovare) po provoj të bëj një analogji ndërmjet luftës, lirisë dhe pavarësisë së Kroacisë dhe popullit kroat dhe luftës, lirisë dhe pavarësisë së Kosovës dhe popullit shqiptar. Liria e shtetit dhe e popullit kroat nuk ka ardhur me profeti, nuk ka ardhur duke u bazuar në Bibël, pra edhe lufta e popullit kroat ka pasur vështirësitë dhe të metat e veta, ka pasur keqpërdorim ose përdorim të forcës joproporcionale në raste të caktuara, ka pasur abuzim nga “Braniteljat” (Mbrojtësit), ka pasur keqpërdorim të pozitive nga pushtetarët pas çlirimit, por nuk ka pasur thirrje për linçim të “Braniteljave” nga intelektualë të botës akademike ose pronarë gazetash, e aq më pak nga njerëz që me përkushtim i shërbyen komunizmit dhe Jugosllavisë. Edhe në Kosovë u luftua për lirinë e vendit kundër të njëjtit armik. Çlirimtarët nuk kishin zbritur nga planetët tjerë. Ata ishin djem e vajza të këtij populli, ishin burra e gra të këtij vendi, luftuan për aq sa ditën dhe mundën, prandaj edhe fati ishte në anën e çlirimtarëve. Krah tyre u rreshtuan forcat më prodemokratike të botës, por as në rastin e Kosovës liria nuk erdhi me profeti, apo duke u bazuar në Bibël a Kuran. Sigurisht që gjatë luftës bëhen edhe gabime, madje gabime të natyrës nga më e ndryshmjat, njerëzore e teknike. Ndodh të pësojnë edhe të pafajshmit. Po i theksoj vetëm dy-tri raste, kur edhe ushtarakët më të përgatitur dhe me teknologjinë më të avancuar gabojnë. Rasti i Korishës, rasti i kolonës së civilëve dhe rasti i Ambasadës kineze janë raste eklatante të gabimeve njerëzore e teknologjike, por askush, madje as Qeveria kineze nuk ka ngrehur akuza e dilema të niveleve çfarë ngrënë kritikuesit kujdestarë të UÇK-së. Nëse dilemat dhe akuzat e këtyre individëve dhe soji i tyre bëhen sipas detyrave zyrtare të atyre që u kanë shërbyer me devotshmëri në kohën e komunizmit, këtë edhe mund ta kuptoj, por nuk mund ta kuptoj kur një pjesë e njerëzve (pa interesa, por edhe pa tru)

këto akuza i shohin me simpati e admirim, e në raste të caktuara edhe u duartrokin. Është interesante se si këto akuza janë në valë të njëjta me ato të shumicës absolute të politikanëve, eprorëve ushtarakë, paramilitarëve e akademikëve serbë. Është për t’u çuditur si ka mundësi që kjo përputhshmëri në mendime e veprime shkon në nivele të përmasave deri në 100 për qind. Është për t’u trishtuar si ka mundësi që nuk kanë turp të deklarohen kështu. Duhet të jesh pa ndjenja për të mos e kuptuar se politika kosovare dhe zhvillimet në vend nuk janë as afër të mundshmes, e lëre më të dëshirueshmes, por është larg më e mirë se ajo e Akademisë së Shkencave Serbe të viteve të ’80-ta që sot e proklamojnë individë të caktuar, që vetes i thonë shqiptarë dhe asaj që e kanë trasuar politikanë e ambasadorë shqipfolës në vitet e ’80-ta, e që sot me nostalgji e proklamojnë djemtë e baballarëve. Lirinë e Kosovës e shijuan të gjallët, ata që kontribuan drejtpërdrejt, sikur edhe ata që ndihmuan në çfarëdo forme për lirinë e vendit. Lirinë e shijuan edhe ata që ishin të lirë dhe nuk kishin nevojë për një liri tjetër, sepse e kishin lirinë e sistemit jugosllav, që me përkushtim e devotshmëri i shërbenin. Tash e sa kohë këta surrogat pa pikë turpi tentojnë të njollosin për aq sa dinë e munden UÇK-në dhe luftën e saj. Këta individë lëshojnë erë kontaminuese ndaj këtyre vlerave sublime të popullit shqiptar, madje ndonjëri nga ta meritat për liri dhe çlirim të vendit ia dedikon politikës, lirinë dhe çlirimin e quan transformim të bërë nga politika, kurse çlirimtarët i quan cuba primitivë. Gjeneralë të nderuar: z. Sylejman Selimi, z. Agim Çeku, z. Bislim Zyrapi, z. Rustem Mustafa, z. Sami Lushtaku, z. Ramush Haradinaj, z. Rrahman Rama, z. Shukri Buja, z. Fatmir Lima, komandantë e eprorë të Shtabit të Përgjithshëm dhe ju eprorë të zonave, jeni transformues apo çlirimtarë, jeni “cuba primitivë, apo...?! Adem e Hamëz Jashari, Zahir Pajaziti, Shkëlzen e Luan Haradinaj, Fehmi e Xhevë Lladrovci, Mujë Krasniqi, Ilaz Kodra, Agim Ramadani, e..., për çfarë luftuat, për çka keni vdekur, çfarë jeni, ...?! Dëshmorë e martirë, gjeneralë e

komandant, ushtarë – çlirimtarë, keni bërë transformim, e çliruat vendin, apo jeni “cuba primitivë”?! Ata që e dhanë jetën, ju që dhatë familjarët, ju që dhatë gjymtyrët, ju që dhatë krejt çka patët, a e kuptoni se çlirimi dhe liria nuk ka një datë, nuk ka një fund, nuk ka një... së paku jo në Kosovë! Sigurisht që shumica absolute e fëmijëve, e grave, e burrave të këtij vendi, por edhe e njerëzve lridashës në mbarë globin ju janë mirënjohës dhe falënderues për çfarë bëtë, por ka edhe të atillë që u quajnë “fajtorë” pse luftuat për liri, sikur që ka edhe të këtyllë që meritat për liri e çlirim përpigën t’i tjetërsojnë, madje lirinë dhe çlirimin e vendit i quajnë transformim, kurse çlirimtarët cuba primitivë. Liria dhe demokracia lejojnë dhe mundësojnë mendimin dhe shprehjen e lirë, sikur që mendjet e secilit nga ne duhet të jenë aktive dhe të vlerësojnë përse ngrihen këto dilema, insinuata e akuza. Askush nuk duhet të provojë shfajësimin e individëve për të bërë apo të pabërë e tyre të pas luftës, por askush nuk do duhej të bie pre e perfiditeteve të kuzhinave të Beogradit, që për asnjë moment nuk pushojnë së punuari për të minuar vlerat e popullit shqiptar të Kosovës. Besoj fuqishëm që secili nga ne së paku e ka dëgjuar thënien se “armiku duhet luftuar nga brenda”, andaj këta surrogat janë miqtë e armiqve të Kosovës, të porositur për t’i luftuar vlerat më sublime të popullit shqiptar nga brenda. Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka luftuar për lirinë e popullit dhe të vendit. UÇK-ja njihet si ushtria më e suksesshme guerile e të gjitha kohëve. UÇK-ja, e mbështetur nga shtresat e gjera të popullit dhe aleatët ndërkombëtarë, nuk ka bërë transformim, por ndryshim rrënjësor. Ajo e solli lirinë për popullin e robëruar, e çliroi vendin nga një robëri padrejtësisht e mbajtur me dekada e shekuj. Pjesëtarët e UÇK-së janë çlirimtarë për ata që e duan vendin dhe lirinë, kurse për të tjerët janë dhe mbeten transformues, “cuba e terroristë”. Duke qenë krenar me luftëtarët Shqiptarë (në këtë rast po veçoj tre nga ta gjeneralët Rrahim Ademi e Agim Çeku dhe dëshmorin Bekim Berisha – Abeja) që u rreshtuan krah çlirimtarëve kroat uroj Kroacinë në përvjetorin e betejës “Oluja”, njëkohësisht çlirimi i e tërë territorit të shtetit kroat.





# Shkjenia dhe Shqypnija në epopenë shqiptare të Fishtës

**Nga: Armin HETZER**  
**Përktheu: Agron TUFA**

Në një pamje të reduktuar, kulturën mund ta përkufizosh si shumë dijeshe dhe vlerash. Në një shoqëri të zhvilluar, këto përmbajtje përcillen në familje dhe në shkollë, në shoqëritë patriarkale, tradita gojore folklorike luan një rol të veçantë. Në disa vende të Evropës juglindore, në radhë të parë ndër sllavët e jugut, folklori letrar rezultoi si dukuri jashtëzakonisht e gjallë. Ende në shekullin e XX-të bardët përhapnin këngët e tyre epike, dhe, nga një pikëpamje pragmatike, ligjërimi poetik ka qenë mjet efektiv i shprehësisë. Në lidhje me përmbajtjen mund të veçosh dy sfera tematike: (a) subjektet legjendare, (b) ngjarjet historike. Kufirin ndërmjet tyre nuk është krejtësisht i qartë, sepse publiku nuk e dallonte njëherë sferë prej tjetres ashtu, sikundërse e bën këtë vëzhguesi i ditur dhe kritik. Subjektet legjendare mund të përmbajnë bërthamë historike, dhe këngët historike mund të jenë të drejtuara për kah tiparet legjendare. Flasin për subjekte historike, nëse personazhet e epopesë historike janë të konfirmuar. Në gjuhën gjermane

përdorim nocionin Heldensagen (gojëdhëna për heronjtë), kurse në letërsinë e huaj, ndër to atë shqiptare, ndeshim nocionin “legjenda” dhe “legjendar”, ani pse fjala është për veprat në vargje. Duke pasur parasysh se folklori letrar gjer në kohët më të reja ka qenë dukuri e gjallë e krijimtarisë, atëherë dhe letërsia artistike e popujve të Evropës juglindore shfrytëzonte subjektet dhe format e epopeve heroike. Përkundër ndarjes në skena, “Kurora e maleve” (1847) e Petër Njegoshit konsiderohet epope apo “poemë liriko-epike”. Xhuzepë Skiro i vjetri (Zef Skiroi), njëri nga arbëreshët italo-jugorë, rreth vitit 1922 krijoi epopenë “Kthimi” – Il ritorno, e cila, megjithatë, u botua vetëm në vitin 1965. Gjithashtu, greku kretas Nikos Kazanxaki krijoi “Odisenë” e tij. Në vigjilje të viteve 1920, Gjergj Fishta krijoi epopenë nacionale shqiptare, “Lahuta e Malcis”, e cila përfundimisht sosisi në vitin 1937. Njegoshi dhe Fishta kanë ndikuar jashtëzakonisht në vetëdijen nacionale të serbëve dhe shqiptarëve, por “Odisea” e Kazanxaqit del jashtë kornizave të temës që na intereson. Në këtë poemë nuk janë pasqyruar konfliktet ven-

dore prej historisë së atdheut të poetit, porse temat gjithënjëzore në formën e palinodisë (ose parodisë) së Homerit. Personazhi Odise, prej të cilit Penelopa dhe Telemaku shmangen të frikur, si prej përdhunuesit, nuk janë të volitshëm për modelet e vetëdijes nacionale. Ndërkaq që pikërisht në këtë gjë qëndron funksioni i epopeve të tjera: ato paraqiten si pika kristalizimi të nacionalizmit bashkëkohor dhe prandaj u duhet servirur masave të gjera të popullsisë mundësia e identifikimit. Punimi i mëposhtëm është një kontribut në imazhologji dhe në studimet për të ashtuquajturin “alternitet” (angl. Otherness). Më parë ka qenë folur në shkencë për idealet kolektive apo stereotipat. Në çdo cilën rrethanë fjala është për standartizimin e arsyetimit, ndjeshmërisë dhe veprueshmërisë, rezultatet e së cilës i kemi quajtur më lart vlera të përbashkëta. Personazhet letrare përfaqësojnë sjellje model, dhe formulat e tyre ligjërimore shprehin kufijëzimin e të “tyres dhe së huajës”. Më poshtë do të hulumtojmë kuptimin e fjalëve shkjenia-a, me të cilat shqiptarët e veriut përcaktojnë fqinjët e tyre sllavë si një kolektiv të huaj.

## Vetëfliji për shkak të vetëdijes së detyrës

“Lahuta e Malcis” përmban 30 këngë, të ndarë në tri pjesë joproporcionale: (1) mbrojtjen e kështjellës së Vraninës në bregun perëndimor të liqenit të Shkodrës (1858-1862, këngët I - V), (2) mbrojtjen e qyteteve Plavë dhe Guci (1878-1880, këngët VI-XXV) dhe (3) periudhën e xhonturqve (1908-1913, këngët XXVI-XXX, që përmbajnë fushat e Shevqet Turgut Pashës kundër fiseve të shqiptarëve të veriut dhe luftën e parë Ballkanike). Kësisoj, epopeja e Fishtës përshkruan konfliktet ushtarake më të rëndësishme, të cilat, në fund të fundit, mundësuan shkëputjen e Shqipërisë nga Perandoria Osmane. Prandaj, gjer në Luftën e Dytë Botërore, “Lahuta e Malcis” quhej epopeja nacionale e shqiptarëve, që glorifikonte çlirimin prej sundimit shumëshekullor turk. Ndërkaq, gjatë kohës së komunizmit kjo vepër artistike ka qenë e ndaluar si brenda vetë Shqipërisë, ashtu edhe në Jugosllavi. Kjo shpuri në atë që pothuaj nuk ka literaturë bashkëkohore mbi “Lahutën e Malcis”; gjer më sot, punimet e Maks Lambercit konsiderohen si fundamentale.

Në folkloristikën shqiptare dallohen Epika legjendare dhe Epika historike. Në të dyja rastet kemi të bëjmë me këngë të shkurtra, të cilat mund të jenë pjesë e ciklit të njohur, por që kurrënjëherë nuk u bashkuan në një epope të madhe të vërtetë. Krijimi i një epopeje të tillë është meritë vetëm e Gjergj Fishtës, i cili shfrytëzoi elementet e të dyja zhanreve folklorike, të epikës legjendare dhe historike. Legjendarja shprehet, ndërkaq, me Frymët (Zanat dhe Orët e besëtytnive popullore shqiptare) që bashkëshoqërojnë luftën e heronjve (IV. 208-275). Elementi historik ka të bëjë me faktin që ngjarjet dhe personazhet, qoftë dhe pjesërisht, janë të dëshmuara historikisht.

Nëse përqendrohemi në fashikullin e parë të Lahutës së Malcis që përmban luftën dhe vdekjen e Oso Kukës (kënga I-V), atëherë, në vështrim të parë paraqitet Shqipëria viktimë e grabitqarisë malazeze. Kështjella e Vraninës ka qenë forpost i Perandorisë Osmane kundër fiseve malazeze që depërtonin në rrafshulltë. Në një situatë pa shtegdalje, Oso Kuka u hodh në erë bashkë me kullën e barotit; përveç kësaj vdiq edhe një pjesë e madhe e mësymësve malazezë. Një



heroizëm i këtyllë ndeshet jo pak në folklorin ballkanas. Të paktën njëra nga këngët heroike për Oso Kukën është dëshmuar që në shekullin e XIX-të. Pikë zanafillore e Fishtës rezulton skena idilike, ku “turq e sllavë” bashkekzistojnë në paqe (urtë ma ndejun Turk e Shkjá. I, 364). Së këndejmi, grabitqaria malazeze relativizohet. Knjaz Nikolla, i ngucur prej carit rus, është shkaku i veprimeve luftarake se, sipas fjalëve të poetit, ai sheh me sy të keq gjendjen paqësore mbi liqen, dhe thërret serdarin Vullo për mësymje. Nga ana tjetër, dhe vetë shqiptarët nuk janë të prirur për luftë. Pas mësymjes së malazeze pashai turk Avdi që udhëhiqte trevën e Shkodrës, ankohet që shqiptarët nuk qëndrojnë burrisht. Puna është se, nuk ndjejnë ndonjë shkullm të brendshëm të luftojnë për hesap të një pashai të huaj, por Oso Kuka nuk mundet të mos e marrë mbi vete detyrën e mbrojtjes së kufijve, kur pashai pëshpërit që shqiptarët janë frikacakë. Mandej një tradhtar i njohur, sllavi Zeliq Gjoka (V. 182) u heq udhë malazezeve në Vraninë, por vritet i pari në luftë.

Ky, thënë shkurt, është një veprim, ndërsa poeti e zbukuron atë me përshkrimin e virtyteve dhe cilësive luftarake të heronjve. Pjesërisht epitetet e sllavëve dhe shqiptarëve janë po ato: ‘trim i çartun’ – si serdari Vullo (I. 280), ashtu dhe Oso Kuka (II, 155). Për Jovanin poeti thotë se është “sokol mali me tre zemra” (III, 236). Megjithatë, ka edhe dallime. Për shembull Vullo grabit luftëtarin e rënë (III. 52), çka i vë njollë reputacionit të tij. Lexojmë mendimin e përgjithshëm se sllavët nuk janë të denjë për t’u zënë besë dhe s’janë njerëz ku mund të

mbështetesh (e thonë Shkjau se besë nuk ká. V. 169).

Mund të thuash në përgjithësi se sllavët që marrin pjesë aktive në betejë, nuk janë marrë nëpër gojë prej poetit. Megjithatë është krejt normale që ai, në radhë të parë, u kushton vëmendje bashkatdhetarëve të vet dhe aplikon të gjitha krahasimet e reja për të nënvizuar burrërinë e tyre dhe glorifikimin e cilësive të tyre: heronjtë krahasohen me gjarpërinjtë (drangue), poshtë kraheve ata kanë tri flatra të arta (apo pendë, IV. 26). Oso Kuka shkëndrit si vetëtima (II. 111; 142) ose buluret si luan (si ulani, III. 195). Kaçel Doda dhe Kerni Gila – janë si dy re të zeza (II. 138; III. 223). Për sfondin politik lexojmë se shqiptarët jetojnë 500 vjet nën zgjedhën turke (I. 4), por ende nuk janë nënshtruar (si ‘i dem, vu n’lavër spari. I. 12). Për besimin fetar poeti-murg thotë se shqiptarët kristianë dhe muslimanë jetojnë në paqe e harmoni (III. 340) dhe se kurrë ata s’kanë për ta pranuar zgjedhën e gospodarit malazes (IV. 66).

Rreziku që u kanoset shqiptarëve është krijimi i një territori të pandarë sllav nga Deti i Bardhë gjer në detin Mesdhe nën udhëheqjen “Moska” (IV. 85-91):

(...) mbasi Shkjetë e Ballkanit (...)

të kenë lidhë besë ndërmjet vetit,

ka m’iu dhanë Shkjenisë e mbara,

ka m’iu shtrure ura përpara

det e m’det m’u kapë Moskovi

(IV. 85-91)

### “Sllavjanin” në vend të Gjaur

Të vetmet përkufijzime konkrete të armiqve që u kundërvihen shqiptarëve, janë malazezët, ndërsa poeti shpesh

i quan ata me etnonimin malazestë. Nga ana tjetër shqiptarët – gjithashtu nën etnonimin e letërsisë së tyre quhen shqiptarë:

Malazestë të gjithë e dijnë

Se n’Shqipni ka djelm si Zana

(IV. 122)

Se për t’gjallë rodi i Shqiptarit

S’i bjen n’dorë kurrë

Gospodarit (IV. 34-35, 66-67)

Megjithatë ndeshen edhe emërtime të tjera që lypin shpjegime. Në citatin e sipërpërmendur shohim ‘sllavjanët’ (në numrin njëjës: shkja-u), Shkjani-a si fjalë përmbledhëse, Moskovi ‘Moska’, Shkina ‘sllavjanka’ (në shumicën e rasteve: zogu i shkinës ‘biri i sllavjankës’ I. 290). Në fund të fundit ndeshet edhe një varg, në të cilin shqiptarët quhen “turq”: urtë me ndejun Turk e Shkjá. I. 364. Ndërsa kjo fjali i përket ligjëratës së drejtë të knjaz Nikollës, mund t’ia atribuojmë gjuhës së folur bisedimore serbokroate (të cilën Fishta e zotëronte).

Emërtimet Moskov-i dhe Shkja-u/Shkina janë marrë prej poezisë popullore shqiptare, për shembull, në vargun *Moskovi kërkon xhaminë/ në Stamboll Agjosofinë* – (Epika Historike, Vol. 2., nr. 426). Fjala Shkja-u, Shkina gjenden shpesh në përmbledhjen Epika legjendare, v. 1 (1966); këtu do të desha të ndërmend që në gjuhën rumune shkja-u asheau, shumës, shkej schei – janë forma të ligjërimin bisedimor, me të cilat shënjuheshin në radhë të parë bullgarët, por edhe ortodoksët në përgjithësi. Në shqip: Fjala Shkjenia ndeshet aty vetëm një herë: *Tanë shkjeninë sot e koriti* (Nr 24. Vargu 276). Duket se Shqenim-i me affiksin – nim rezulton variant dialektor. Çfarë domethënie pra ka kjo fjalë dhe


ç’prej kuri aplikohet?

Në shek. XX Shqipni-a/Shqipëri-a rezulton emërtimi zyrtar i vendit Albania, pra emërtim gjeografik. Në këngët heroike edhe tek Fishta kontrastojnë Shqipnia dhe Shqenia, dhe mund të hamendësojmë që ky nuk është rezultat i rastësishtëm i fjalëformimit paralel me sufiksin – ni. Duhet supozuar që të dyja fjalët kanë në zanafillë kuptim të dyfishtë: (a) përmbledhës që shënjojnë një popull të caktuar (apo nacionalitet), (b) emërtimin e territorit të një populli të dhënë. Një formim analogjik ekziston dhe në gjuhët e tjera, për shembull, në gjuhën polake, në të cilën Niemcu do të thotë (a) ‘gjermanët’ (b) ‘Gjermania’. Në mënyrë të ngjashme edhe Arnautluk nuk do të thotë vetëmse territor gjeografik, por mund të shënjojë dhe karakterin shqiptar, d. m. th. cilësi abstrakte në kuptimin e veçorisë nacionale. Presupozohet që përmendja më e hershme e fjalës shqipe Shqeni-a ndeshet në fjalorin e Francisk Bardit (Frang Bardhit) në 1635 në faqen 144: sclauonia – Schienia. Sikundër Sclavonia, Schiavonia nuk është fjalë përmbledhëse, në rastin e dhënë kemi të bëjmë me emërtim gjeografik, anipse jo në kuptimin bashkëkohor. Sepse në kohën e republikës venedikase duhet të mendojmë për bregdetin dalmat, jo si për Sllavoninë bashkëkohore ndërmjet Savës dhe Dravës. Pa kontekst është vështirë të thuash, çfarë kishte pikërisht ka pasur parasysh Frang Bardhi në 1635, por, ashiqare, në radhë të parë jo atë për çka ka shkruar Fishta. Së këndejmi, duhet të përcaktojmë domethënien e fjalës Shqeni-a në kontekstin e epopesë sonë dhe burimet e saj,

epikës popullore.

Te Fishta Shqipnia së pari nuk ka më domethënie gjeografike dhe, së dyti, Shqenia në vendin e sipërpërmendur (IV. 85-90) nuk ka lidhje me ndofarë toke. Sepse nuk ka të tillë vend i cili të mund të shtrihej nga Moska gjer në detin Adriatik. Shqenia në kuptimin jospecific mund të kishte qenë “toka e sllavjanëve”, një shtet tërësor i papërcaktuar. Fill pas Maks Lamercit në rastin e dhënë është më e mira ta përkthejmë këtë fjalë me shprehjen “të gjithë popujt sllavë”. Po përse pra fjala bie vetëm për popujt sllavë, ndërkaq që malazestët kanë një profil mjaft të qartë, që të mund të jenë të kategorizuar kësodore?

Mund të hamendësohet se shpjegimi qëndron në faktin se Fishta përdor këtu fjalëpërdorimin e epikës heroike, më saktë imiton ciklin e Mujit dhe Halilit. Kjo dëshmohet bindshëm, nëse marrim parasysh jo vetëm episodin për Oso Kukën, por edhe këngë të tjera, në të cilat krijesat mitike marrin pjesë në veprim (këngët XVI, XXIV). Ata e mbajnë lidhjen me këngët legjendare më të qartë, sesa baladat historike. Fishta krijoi sintezën e dy zhanreve; veçse subjekti në epopenë e tij është historik; formësimi poetik imiton dukshëm epikën legjendare. Tani të hyjmë në një sferë të diskutueshme, përderisa Maks Lamerci – dhe mbas tij folkloristika zyrtare shqiptare – këmbëngulin për lashtësinë e ciklit të Mujit dhe Halilit. Sikundërse supozohet, konflikti rreth Mujit dhe Halilit pasqyron luftën në lidhje me migrimin (dyndjen) e ngulimin në gadishullin ballkanik në shek. VI të erës sonë. Atëherë, pra, ardhacakët sllavë lufton vazhdimisht me “ilirjanët”







autoktonë.

Mirëpo, në shkencë tashmë ka kohë që është evidentuar ngjashmëria e ciklit shqiptar me ciklin e sllavëve të jugut për Mujin dhe Halilin. I fundit është regjistruar në shekullin XIX në Bosnje. Stavro Skëndi, shqiptar, i cili vonë ka qenë profesor në ShBA, vërtetonte imtësisht që cikli shqiptar varet prej atij boshnjak dhe që ai nuk mund të jetë më i vjetër se 300-400 vjeç. Për këngët heroike shqiptare, Skëndi shkruan: *“Rrjedhimisht, rapsodët nuk mund të konsiderohen më të vjetër se shekulli XVIII”*. Arshi Pipa, një tjetër shqiptar, që jep leksione në ShBA, ka shkruar madje që *“cikli shqiptar e ka zanafillën në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit të kaluar”*. Zgjidhja e kësaj çështjeje do të kishte qenë për ne pa interes, nëse në ciklin boshnjak të kontrastin Turak dhe Sllovenin. Porse në ciklin boshnjak nuk ka vargje me etnonimin “sllavjanin”; përmenden veçse emërtime sociale si vllah, raja etj., të cilat i kundërvihen “turku-t”.

Fjala vllah shpesh përkthehet në kuptimin e arumunit, d. m. th., në fiseve të romanizuara paleo-balkanike. Në rastin e dhënë, kushërinjtë rumunë të përtejdanubit nuk dalin si personazhe të këngëve epike. Vëlla në ciklin boshnjak shënjohe serbët që janë ngulmuar në territorin e republikës venedikase (më vonë dhe Austro-Hungarisë). Fjala raja rezultoi emërtim zyrtar i nënshtetasve myslimanë të sultanit. Kjo do të thotë që në përgjithësi nuk ka emërtime nacionale në këngët boshnjake, pse të gjithë personazhet – janë sllavët e besimeve fetare të ndryshme. Më shpesh nga të gjitha ndeshet kontrasti, turak apo turçin, respektivisht kaur

(turak – gjaur), d.m.th. ai që i beson të pafeut. Veçantia e ciklit shqiptar qëndron në faktin që përsëpari paraqitet kontrasti jo mbi bazën religjioze, por sipas përkatësisë nacionale. Ajo çka ka qenë gjaur në ciklin boshnjak, në këngët shqiptare u zëvendësua funksionalisht me personazhin sllavian – shkja-u. Skëndi (1954, fq 128) rezymon hulumtimet e tij me fjalët e mëposhtme *The Bosnian fights against the kauri and vlasi (Vlachs), both being Christian subjects of the German Emperor or of the Doge of Venice. The Christian citizens within the boundaries of the Ottoman Empire are called in their songs raja (Rayah). The Albanians wage wars on the Shkje and the kaur (infidel). The terms vllah (Vlach) and raja are used in their songs, but they are rare, particularly the former.*

Këngët heroike shqiptare kanë qenë regjistruar, si rregull, në fiset katolike të malësisë; prandaj termi gjaur/kaur “i pafë” nuk vlen për shënjimimin e armikut. Por, ekzistojnë këngë në të cilat aplikohet fjala kaur, afër me fjalën shkje apo shkjenin. P. sh., në këngën e sipërpërmendur *“Halili i qet bejleg Mujit”* nga rajoni Shkrel, gjen vargjet: Me i dhanë Mujit laikun e dekës/e me hjek havalen e kaurrit *“që ta ndëshkojë Mujin me vdekje, që ai të rënkojë nga hidhërimi nga ana e kaurrit”*. Në po atë tekst ndeshim dhe fjalët vladika dhe popi në anën sllave. Ndoshta janë zbuluar këtu sfondet e njohura nga epika mitike me realitetin empirik, konflikti luftarak me serbët ortodoksë (kënga është regjistruar në Kosovë). Në këtë rast, do të kishim punë me eklektikën e mitikes dhe elementit historik, si edhe në “Lahutën e Malcis” së Fishtës.

### Nuk ka armiqësi të trashëguar

Etonimet te Fishta shkja/ shkja dhe malazez, më pak apo më shumë, janë sinonime, megjithëse konotacioni i fjalës shkja është mitik, ndërkaq që termi malazez është i pamallkuar dhe neutral. Shkjeni si fjalë përmbledhëse ndeshet mjaft rrallë, dhe atëherë me kuptimin që del prej kufijve të fqinjësisë gjeografike. Kështu shënjohe sllavët në përgjithësi dhe me ta shqiptarët veriorë zor të kenë pasur kontakte të drejtpërdrejta. Më fashikullin për Oso Kukën, emëruesi i përbashkët shkjeni nuk luan rol përveçse si njësi politike e largët që u kanoset. Shqiptarët përcaktohen si jo sllavë në bazë të kolektivit etnik, pa nuanca religjioze. Fjala turk do të thotë si rregull mysliman, siç del nga vargjet e mëposhtme (III. 338-341)

*por kur Shkjau t'na ngasë  
n'vend t'Parëve  
për ketë besë, fara e Shqiptarëve  
turk e i k'shtenë – merr vesht or  
djalë –*

*kanë me u gjetun krejt me 'i fjalë*  
Fishta nënvizon që knjazin malazes e cyt cari në Moskën e largët dhe poeti nuk propagandon urrejtje. Tragjedia historike qëndron në atë që për shqiptarët mbrojtja e atdheut në të njëjtën kohë do të thotë mbrojtje e kështjellave kufitare të perandorisë osmane. Vetëm se ndërhyrja e Fuqive të Mëdha në fatin e popujve të vegjël i bën shqiptarët armiq me fqinjët e tyre sllavë. Nga pikëpamja e kulturologjisë, fjala shkjeni përmban nocion privat të përkufizuar prej “të huajit”, në kuptimin e “alteritetit” (angl. otherness). Por, ky nocion rezultoi i papërcaktuar. Poeti nuk u kundërvë vlerave pozitive të

kolektivit personal, që dallohen me tipare të prera apo me simptoma të kolektivit të huaj. Kontrasti është i dobët, sikundërse në përgjithësi malazezët dhe malësorët në shumë gjëra janë afër njëritjetrit.

*(Ky studim u mbajt në rusisht në Akademinë e Shkencave Ruse gjatë konferencës së studimeve ballkanistike më 3 mars 1999, organizuar nga Instituti i Sllavistikës dhe Ballkanistikës)*  
Literatura

(Blanchus, Francisus) Bardhi, *Frang: Fjalor latinisht –shqip 1635. Reprinting hrsg. von E. Sedaj. Prishtina: Rilinja, 1983, S. 226 (Biblioteka Lingusitikë)*  
Fishta, GjergjLahuta e Malcis. Romë. Qendra e katolikëve shqiptarë jashta atdheut, 1991, XXXI, 520 (3) S. – dt. Übers. Die Laute des Hochlandes, Übersetzt, eingeleitet und mit Ammerkungen versehen von Max Lambertz. München: Oldenbourg 1958, 312 S. (Südosteuropäische, Arbeiten, 51)

Fjalor Enciklopedik Shqiptar. Tiranë, 1985, S. 569 (s. v. Kuka, Oso).

Hansen, Klaus P. (1995): Kultur und Kulturwissenschaft. Ein Einführung. Tübingen und Basel: Francke 221 S. (UTB 1846)

*Istoriya Jugoslavii. Red. Ju. V. Bromlej & al. Moskau: AN SSSR, Bd. I., 1963, S. 605-607.*

*Istoriya Juvoslavije. Hrsg. Ivan Bozic & al. Beograd: Prosveta, 21973, S. 259.*

*Istoriya literatur zapadnych i juznych slavjan, Bd. II (Red. S. V. Nikol'skij. Moskau: Indrik 1997. ISBN 5-85759-058-2.*

*Kadare, Ismail: Dosja H. Roman. Tiranë, Naim Frashëri, 1990, 230 S.*

*Kazantzakes, Nikos: Odyssee. Ein modernes Epos von Nikos Kazantzakis. Übertragen in deutsche Verse von Gustav A. Conradi. München: Desch 1973 xviii, 770 S. – Griech. Original: Odysseia. Athen.: Ekdoseis El. Kazantzake, 1974, 898 S.*

Lambertz Maximilian (1949): *Gjergj Fishta und das albanische Heldenepos Laute des Hochlands. Eine Einführung in die albanische Sagenwelt. Leipzig: Harrasowitz, 76 S.*

Murko Matija (1951): *Tragom srpsko-hrvatske narodne epike. I. Knjiga. Zagreb, S. 272 (Djela JAZU, 41).*

*Narodne pjesme Muslimana u Bosni i hercegovini. Iz rukopisne ostavstine Koste Hormanna. Redakcija, uvod i komentar Denana Buturovic. Sarajevo: Zemaljski muzej BiH, 1966, 230 S.*

*Njegos, Petar Petrovic: Gorski vijenac. Luca mikrokozma. Beograd 1984 (Celokupna dela Petra II petrovica Njegosa, 3). Pipa, Arshi (1984): “Serbocroatian and Albanian Frontier Epic Cycles”, in: Studies on Kosova. Ed. By A. Pipa & S. Repishti. New York: Columbia University, S. 85-102 (East European Monographs, No. CLV)*

*Schirò Giuseppe, sen. : Këthimi – Il ritorno. Poema postumo con introduzione e a cura di Giuseppe Schirò Junior. Firenze: Olschki 1965, 24, 260, S. (Studi Albanesi. Studi e Testi, II). Skendi Stavro (1954): Albanian and South Slavic Oral Epic Poetry. Philadelphia, S. 29 (Memoirs of the Mmerican Folklore Society, Vol. 44), Kraus-Reprint 1969. Slovar literaturovedceskich terminov. Hrsg. L. I. Timofeev & S. V. Turaev. Moskau: Prosvescenie 1974, S. 472 ff. (s. v. epopeja, epos)*



**E rrallë**

# Zgjidhet misteri i Stonehenge?

Zbulohet prejardhja e gurëve të famshëm të Stonehenge, siti arkeologjik i ndërtuar rreth 3 000 vjet më parë. Prej më shumë se 4 shekujsh njeriu është përpjekur ta gjejë prejardhjen e tyre, domethënien, mënyrat e përdorura për zhvendosjen e këtyre gjigantëve, duke i mbuluar në mister ende sot. Por njëri prej tyre duket se është zgjidhur në bazë të analizave kimike të Sarsen-masivëve gurorë. Të paktën 50 prej tyre, nga 52 që janë, kanë prejardhje të njëjtë dhe e kanë origjinën në West Woods, në kontenë e Wiltshire, rreth 25 km larg nga siti arkeologjik i periudhës së neolitit, Stonehenge. Nga analizat me teknika jashtëzakonisht të avancuara, rezultoi se këta gurë gjigantë me peshë mesatare 20 tonë, kanë përbërje kimike pothuajse të njëjtë,



çka të bën të mendosh se janë krijuar bashkë dhe shkëputur nga e njëjta zonë apo masiv shkëmbor. Zbulimi është mjaft i rëndë-

sishëm pasi deri më sot mendohej se këta gurë mbërrinin nga një vend në veri të lumit, në Marlborough Downs.

## BARSOLETA E DITËS



**Babi:** Ku po shkon moj bijë tani në gjysmë të natës?

**Vajza:** Në banjë, babi.

**Babi:** Pse?

**Vajza:** Urgjentisht më duhet të bëj një foto të re profili.



### Në Kino ABC nuk ka shfaqje



## FOTO E DITES



Pamjet relaksuese që të ofron qyteti bregdetar i Ksamilit, një destinacion për t'u mos u humbur. /LSA/

## E jashtëzakonshme

# Zbulohet një prej tuneleve më të sofistikuara në historinë e Amerikës

Autoritetet amerikane kanë zbuluar një tunel të papërfunduar 400 metra të gjatë nën kufirin me Meksikën. Ujësjellësi, ventili dhe sistemi hekurudhor janë zbuluar në tunel. Tuneli është zbuluar nga agjentët federalë në bashkëpunim me Agjencinë e Emigracionit dhe administratën doganore amerikane në shkretëtirën afër San Luis në Arizona, ka njoftuar Agjencia Amerikane e Emigracionit. Në tunel, i cili është i lartë 1.2 metra dhe

rreth një metër i gjerë, është zbuluar edhe sistemi i ventilimit, tubat e ujit, telat e energjisë elektrike dhe sistemi hekurudhor, njoftuan autoritetet kompetente. Tuneli është zbuluar duke përdorur stërvitje dhe kamera nëntokësore, pasi ishte zbuluar një shatërvan në afërsi të gardhit në kufi. Zëdhënësi i kontrollit kufitar në sektorin Yuma, Vini Duleski, ka thënë se tuneli i zbuluar është një nga më të sofistikuarit në historinë e ShBA-së.

 <p><b>DASHI</b> Yjet dy ditët e para të javës do ta vënë në qendër të vëmendjes sektorin e mallrave materiale, lehtësojnë suksesin në profesion dhe në menaxhimin financiar.</p>	 <p><b>DEMI</b> Më mirë të jesh i kujdesshëm, veçanërisht me fjalët dhe takime të fshehta dhe hidhërimet ndaj një personi tjetër që nuk është partneri juaj zyrtar.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Dita e sotme do të jetë më e përshtatshme për meditim sesa për veprim. Yjet do t'ju bëjnë të keni një ditë të mbushura me ndjesi të bukura.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Dy ditët e para të javës do të jenë më të hapur për të tjerët dhe në të njëjtën kohë më rezistent dhe të sigurt kur duhet të shpreheni.</p>	 <p><b>LUANI</b> Mungesa e elasticitetit dhe pasigurisë mendore, e cila do t'ju karakterizojë gjatë ditës, do t'ju ngadalësojë dhe ngatërrojë në veprime dhe zgjedhje.</p>	 <p><b>VI RGJËR ESHA</b> Do të jenë ditë konstruktive plot dashuri. Gjëja e rëndësishme është të mos e prisni të pamundurën dhe të mos tregoheni kokëfortë për detajet.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Ngjarjet e ditëve të ardhshme do ta konfirmojnë gatishmërinë tuaj për të ndërmarrë veprime vendimtare, që synojnë përmirësimin e jetës suaj të dashurisë.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Flisni me partnerin tuaj për këtë: do të zgjidhni shumë më tepër nga sa mendoni. Momentet e krizës me partnerin tejkalohen me një sens më të madh realiteti.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Ju mund të merrni një vendim që mund ta ndryshojë jetën tuaj të përditshme. Trego cilësitë e tua si optimizëm dhe një ndjenjë të fortë drejtësie.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Yjet e ditës së sotme dhe të nesërme premtajnë emocione të mëdha, ndjesi dhe ngjarje në të cilat ju mund të shihni të plotësuara dëshirat tuaja më të thella.</p>	 <p><b>UJORI</b> Në dy ditët e para të javës lind konfuzioni dhe dembelizëm. Paqëndrueshmëria emocionale dhe frika që ju mund të ndjeni do t'ju bëjë më pak diplomat.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Do të keni risi të këndshme në dashuri. Në qytet ose me pushime ka mundësi të jeni të kënaqur me mënyrën tuaj të jetesës.</p>



## Arbana Osmani pozon në bikini nga pushimet



**M**oderatorja e njohur shqiptare Arbana Osmani është duke i vazhduar pushimet e saj në bregdet. Derisa është në pritje të ëmbël, ajo po i shijon ditët e nxehta në Shqipëri. Arbana me

ndjekësit po ndan imazhe të ndryshme në rrjete sociale dhe shihet se shtatzënia i ka dhënë shumë nur. “E dua këtë vend”, ka shkruar ajo pranë fotografisë së publikuar në “Instagram”.

## Ilary Blasi “ndez” “Instagram”-in




**I**lari Blasi, prezantuesja dhe aktoria e famshme italiane, ka shfaqur linja të përkryera në plazh, edhe pse është shumë pranë të 40-ave. Ajo nuk është kursyer me foto tekta merr rreze dielli dhe shijon lundrimet me jahte luksoze. Edhe pse bashkëshorti i saj, ish-kapiteni i Romës, Françesko Toti, duket më i

tërhequr në rrjetet sociale, ajo nuk e ka lënë pas dore dhe ka publikuar në profilin e vet foto me të. Çifti po i kalon pushimet e kësaj vere së bashku me tre fëmijët, Kristian, Shanel e Isabel në brigjet italiane e, megjithatë, kur Ilari zhvishet, spektakli vazhdon edhe jashtë televizionit.




## Kimi dhe Kanye nisin pushimet së bashku

**K**im Kardashian dhe Kanye West kanë qenë shumë të komentuar kohët e fundit, shkruajnë mediat e huaja. Ata nuk i kanë pasur punët edhe aq mirë me njëri-tjetrin andaj edhe u bënë cak i mediave rozë. Së fundmi paparacët i kanë fotografuar së bashku dhe thuhet se ata i kanë nisur pushimet. Kim po tenton që ta shpëtojë martesën me reperin, raporton “Daily Mail”. Për këtë arsye ata vendosën që së bashku me katër fëmijët e tyre të pushojnë një javë në Republikën Domenikane.



## Simon Cowell thyen shtyllën kurrizore



**S**imon Cowell, personi që mban firmën e krijimit të “America’s Got Talent”, është shtruar në spital. Mësohet se ai është rrëzuar nga biçikleta në oborrin e shtëpisë së tij në Malibu të Kalifornisë. Përfaqësuesi ligjor i Cowell ka treguar se shefi i tij po provonte biçikletën e re elektrike, por nga

pakujdesia ka rënë. Kështu, ai ka marrë frakturë në shtyllë kurrizore, por nuk dihet ende se në çfarë shkalle është dëmtimi. Simon Cowell është duke u mbajtur nën vëzhgim nga një ekip mjaft i mirë mjekësor, megjithatë, e rëndësishme për ta është që incidenti mos t’i ketë shkakuar atij dëmtime në palcën kurrizore.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Islami: Kam kontakte me Ballkanin, shpejt vendosi për të ardhmen

Përparim Islami ka thënë të hënën për "Epokën e re" se shumë shpejt mund të vendosë për të ardhmen e vet, kurse klubi i ri mund të jetë Ballkani. "Kam kontakte me skuadrën e Ballkanit. Që disa ditë kemi bisedime dhe gjithçka është e hapur. Pra mund të nënshkruaj me këtë klub", ka thënë Islami



reprezentues i Kosovës U19 dhe së fundmi ishte pjesë e KF Ferizajt. Halili është bashkuar sot me skuadrën dhe do të vijoj të jetë pjesë e klubit në tre vjetët e ardhshëm", thuhet në njoftimin e Llapit.

**Hajdini: Jam lojtar i lirë**

Ish-portieri i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Bledar Hajdini, nëpërmjet një postimi në profilin e vet në "Facebook", ka thënë se tash është lojtar i lirë dhe se problemet me dokumentacionin e ka rregulluar nëpërmjet Federatës së Futbollit të Kosovës. "Dua t'ju informoj që nga sot jam lojtar i lirë sepse deri sot kam pasur probleme me dokumente të cilat përmes FFK-së i kam rregulluar. E mira e gjithë kësaj është se gjatë gjithë kohës jam përgatitur dhe stërvitur që të rikthehem në nivelet sa më të larta ku edhe kam qenë. Shumë shpejt do të njoftoheni për ekipin tim të ri sepse jam në bisedime me disa skuadra", ka thënë Hajdini. Portieri 25-vjeçar ka qenë pjesë e Llapit, Ballkanit dhe Trepçës '89.

**EPOKA E RE**

**Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 10 GUSHT** - Mbrojtësi Përparim Islami është një nga lojtarët më të mirë në futbollin e Kosovës. Ai në dy vjetët e fundit ka luajtur me plot sukses për skuadrën e Feronikelit, kurse është afër që të ndërrojë klub në këtë afat kalimtar. I kontaktuar nga redaksia e sportit e gazetës "Epoka e re", Islami ka bërë me dije se Ballkani është skuadra që ka shfaqur interesim dhe brenda orëve në vazhdim mund të nënshkruajë marrëveshje me këtë klub. "Kam kontakte me skuadrën e Ballkanit. Që disa ditë kemi bisedime dhe gjithçka është e hapur. Pra mund të nënshkruaj me këtë klub", ka thënë Islami, i cili me plot sukses

ka luajtur edhe për Feronikelin dhe Trepçën '89. "Ka interesim edhe nga drejtuesit e Feronikelit që ta vazhdojmë bashkëpunimin edhe për kampionatin e ardhshëm", ka shtuar Islami. Muaj më parë për mbrojtësin e djathtë interesim kishin shfaqur edhe dy skuadra nga Superliga e Shqipërisë, por lëndimi i pësuar pak javë para fundit të kampionatit ka bërë që interesimi i klubeve shqiptare të zbehet.

**Maliqi prezantohet te Prishtina**

FC Prishtina e ka prezantuar futbollistin Behar Maliqi i cili vite më parë ishte kapiteni i kësaj skuadre. Maliqi me Prishtinën ka qenë i angazhuar për pesë

edicione me bardhekaltrit, 2008-2013, 104 paraqitje zyrtare, 11 gola dhe dy tituj kampioni, një kupë dhe një superkupë. Behar Maliqi është futbollisti me më së shumti tituj kampioni në Kosovë, gjithsejtë pesë herë është shpallur kampion i Kosovës. "Është kënaqësi e madhe për mua të kthehem në klubin ku jam formuar si lojtar. Falënderoj udhëheqjen e klubit dhe trajnerët për besimin që kanë tek unë. Shpresoj që ky vit të jetë i Prishtinës dhe t'i arrijmë qëllimet që i kemi", ka thënë

Maliqi për faqen zyrtare të Prishtinës.

**Halili prezantohet te Llapi**

Skuadra e Llapit ka prezantuar mbrojtësin ferizajas Gentrit Halili. Lajmi është dhënë nga faqja zyrtare e skuadrës nga Podujeva. Halili ka nënshkruar kontratë trevjeçare me skuadrën që drejtohet nga trajneri Tahir Batatina. "KF Llapi njofton se ka arritur marrëveshje trevjeçare me qendërmbrojtësin 18-vjeçar Gentrit Halili. Ai është

## Marmarinos përkrah formimin e Kosovës A te femrat

**PRISHTINË, 10 GUSHT** - Përzgjedhësi i Kosovës në basketboll, Christos Marmarinos, e ka përkrahur formimin e ekipit përfaqësues të Kosovës në konkurrencën e femrave, kategoria seniore. Sipas tij, është mirë që tash e tutje edhe Kosova do ta ketë përfaqësuesen A e cila mund të jetë konkurrese.

"Basketbolli është sporti i të gjithëve! Më vjen mirë që Federata e Basketbollit e Kosovës po planifikon ta formojë Përfaqësuesen A të femrave, që do të garojë në Kampionatin Evropian për Shtete të Vogla. Vajzat e reja tani mund të ëndërrojnë ta përfaqësojnë vendin e tyre. Është më e rëndësishme se

kurrë t'i ofrojmë rinisë një ëndërr dhe mënyrën për ta arritur atë. Përshëndes iniciativën e Federatës e cila do të sigurojë të ardhmen e femrave në sport. Shpresoj se e gjithë Kosova do ta përqafojë këtë përpjekje. Unë me siguri do të jem një nga tifozët! GO KOSOVA!!", ka thënë Marmarinos.



## Prishtina dhe Gjilani mësojnë kundërshtarët nëse kualifikohen në raundin e parë

**PRISHTINË, 10 GUSHT** - Në Nyon të Zvicrës të hënën është hedhur shorti për raundin e parë kualifikues të Ligës së Evropës. FC Prishtina ka mësuar emrin e kundërshtarit të mundshëm, gjithmonë nëse kalon tutje nga rundi preliminar. Klubi kryeqytetas në rast të kualifikimit në

raundin e parë do të luajë ndaj Union Titus Petange të Luksemburgut. Prishtina do të luajë si vendëse në këtë sfidë. Kujtojmë se në raundin preliminar Prishtina do të luajë në Gjibraltar ndaj Lincoln Red Impsit. Gjilani ka mësuar emrin e kundërshtarit të mundshëm,



gjithmonë nëse kalon tutje nga rundi preliminar. Në shortin e

hedhur në Nyon të Zvicrës, ekipi i Gentian Mezanit në rast të kualifikimit në raundin e parë do të luajë ndaj APOEL-it të Qipros. Gjilani do të luajë si vendëse nëse kualifikohet në raundin e parë. Para ndeshjes së mundshme me Qipron, Gjilani duhet ta eliminojë fillimisht në raundin

preliminar ekipin e Tre Penne. Edhe Prishtina e ka mësuar emrin e kundërshtarit të ardhshëm. Klubi kryeqytetas, në rast të kualifikimit në raundin e parë, do të luajë ndaj Union Titus Petange të Luksemburgut. Prishtina do të luajë si vendëse në këtë sfidë.

## Filloi afati kalimtar në basketboll

Prishtinë, 10 gusht - Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) ka njoftuar të gjitha klubet se të hënën filloi afati kalimtar për basketbollistë/e të huaj dhe vendorë.

Afati kalimtar do të mbyllet më 7 shtator. Ndërkaq më 1 gusht ka filluar paraqitja e klubeve në të dy konkurrencat, si dhe për kategoritë e reja për edicionin 2020-

2021. Afati i paraqitjes së klubeve për edicionin e ri do të vazhdojë deri më 20 gusht, kur është dita e fundit që klubet të regjistrohen. Klubet, pas plotësimit me të dhë-

nat, të njëjtin formular së bashku me certifikatën e regjistrimit të OJQ-së duhet ta dërgojnë në adresën elektronike kome-sari@basketbolli.com.





## 'Dugi' rikthehet në Dukagjin

**KLINE, 10 GUSHT** - Dugagjin Gashi, pas ndarjes me Besën e Pejës, është rikthyer sërish në skuadrën e Dukagjinit të Klinës. Mesfushori pejan ishte

pjesë e Dukagjinit kur ky klub arriti të inkuadrohet në Superligë. Në të kaluarën ai ka luajtur me sukses edhe për Feronikelin, Drenicën, Vëllaznimin dhe Istogun.

"Mesfushori pejan Dugagjin Gashi edhe zyrtarisht është rikthyer pas një viti të kaluar te Besa e Pejës. 'Dugi', një ndër mesfushorët më të mirë që ka pasur futbollin

ynë, me një karrierë të jashtëzakonshëm në futbollin e Kosovës, bëhet përsëri dukagjinasi", thuhet në njoftimin e skuadrës së Dukagjinit.



## Statuja e Fadil Vokrrit, drejt përfundimit

**PRISHTINË, 10 GUSHT** - Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ka vizituar artistin llapjan Agron Blakçori i cili është duke punuar skulpturën e statujës së Fadil Vokrrit.

Ministrja Dumoshi ka thënë se sot ka qëndruar në Llap për një arsye të veçantë, e cila ka konfirmuar se statuja e Fadil Vokrrit është në përfundim. "Më mrekulluan deri në emocion mjeshhtëria dhe reflektimi i Fadilit, të cilin shpejt do ta kemi në bronz", ka thënë Dumoshi. Ministrja Dumoshi ka bërë me dije se faza e modelimit veçse ka përfunduar. Shumë shpejt do të përfundojë faza e gipsit dhe puna do të kurorëzohet me derdhjen në bronz të statujës së Fadil Vokrrit, e cila do të ketë një vijë vertikale 3.5 metra. "Shpirtin e Fadilit vërtet nuk e



pasqyron asnjë statujë sepse madhështia e tij dominon secilën skalitje. Sidoqoftë, vetëm kështu do ta ruajmë të përjetshëm kujtimin për të, të përjetësuar për vendin ku ai dha gjithë dijen, potencialin e energjinë", ka deklaruar ministrja Dumoshi me rastin e inspektimit të fazës së punimit të statujës së Vokrrit.

Ministrja shfrytëzoi rastin edhe për ta falënderuar për punën, skulptorin llapjan Agron Blakçori, i cili me angazhimin e tij të përshtur po e punon denjësisht statujën e legjendës Fadil Vokrrit. "Reflektimi i Fadilit të skalitur do të jetë frymëzim për gjeneratat e reja të sportistëve të cilët, falë punës dhe përkushtimit të tij, sot prekin majat e sukseseve sportive nëpër botë", ka deklaruar ministrja Dumoshi.

## Clippersat zhgënjëjnë ndaj Brooklynit



**ORLANDO, 10 GUSHT** - Në Orlando vijojnë të luhen ndeshjet e mbetura të sezonit të rregullt, aty ku NBA-ja ka rinisur pas pandemisë së Covid-19 dhe vijon sezonin 2019-2020. Spikat fitorja me rezultat 129-120 e Brooklyn ndaj Clippersave, humbje që prish shumë punë për ekipin kalifornian. Brooklyn dominoi në ndeshje, ku u dalluan LaVert me 27 pikë e Harris me 25, duke

i bërë të pavlefshme 39 pikët e Leonardit për Clippersin. Fiton skuadra e Houstonit, që mundi 129-112 Sacramenton, ndeshje me dy pamje. Teksanët dominuan në takim në pjesën e dytë, ku diferencën e bënë Riversi me 41 pikë e Hardeni me 32. Pas kohës shtesë fiton Bostoni, që mundi 122-119 Orlandon, me Haywardin që realizoi 31 pikë.

### REZULTATET

Oklahoma - Washington	121-103
Toronto - Memphis	108-99
New Orleans - San Antonio	113-122
Boston - Orlando	122-119
Portland - Philadelphia	124-121
Sacramento - Houston	112-129
Clippers - Brooklyn	120-129

### SHKURT

#### Lazio arrin marrëveshje me Muriqin

Drejtuesit e Lazios raportohen se kanë udhëtuar drejt Stambollit për negociatat finale me Fenerbaçen për sulmuesin Vedat Muriqin. "Sky Sport Italia" dhe "SportItalia" pretendojnë se shqiptari mund të transferohet në Serinë A për një shumë rreth 18 milionë euro. Sulmuesi i Kosovës ka shënuar 17 gola dhe ka dhuruar 7 asistime në 36 ndeshje me Fenerbaçen këtë sezon.

#### Daja prezantohet si trajner i ri i Partizanit

Klubi i Futbollit Partizani ka zyrtarizuar Ilir Dajën trajner të ri të skuadrës. Daja mbylli bashkëpunimin me klubin e Skënderbeut derisa u shpreh se ka ardhur për të sjellë te të kuqtë mentalitetin fitues që e ka zbatuar në çdo klub që ka drejtuar. "Jam i gëzuar që m'u besua ky projekt. Falënderoj presidentin dhe drejtorin. Po ta shihni investimin modern e kuptoni që nuk është një projekt sot për sot, por edhe për të ardhmen. Unë dua që Partizani, që ka fituar 16 herë, ta vazhdojë edhe këtë sezon. Partizani ka pritshmëri maksimale. E dëgjova drejtorin me vëmendje. Do të dalim me objektiv konkret kur të fillojë kampionati", ka thënë Daja.

#### Reali 'çmendet' pas Dybalas

Real Madridi e ka rikthyer interesimin për yllin e Juventusit, Paolo Dybala. Klubi spanjoll është i gatshëm të ofrojë 100 milionë euro për argentinasi që u shpall lojtari më i mirë në Serinë A. Në marrëveshje për transferimin e Dybalas, Reali mund ta përfshijë njërin nga mesfushorët Isco (60 milionë) ose Toni Kroosin (50 milionë).

#### Dy raste me Covid-19 në skuadrën e Athleticos

Tronditet Atletico Madridi. Pjesëtarët e klubit spanjoll u janë nënshtruar tamponëve dhe dy lojtarë kanë rezultuar pozitivë me koronavirus. Emrat e tyre nuk zbulohen, teksa kanë nisur menjëherë karantinën. Lajmi raportohet nga "Colchoneros" me anë të një postimi në "Twitter". Ekipi i Diego Simeones është kualifikuar në çerekfinalët e Ligës së Kampionëve. Shorti i vuri përballë gjermanëve të Leipzigit, sfidë që është programuar të luhet më 13 gusht (21:00).

#### Flick: Nuk kemi frikë nga Barça dhe Messi

Kundërshtari i ardhshëm i Bayern Munchenit në Ligën e Kampionëve është skuadra e Barcelonës. Trajneri i Bayernit, Hans-Dieter Flick, ka thënë se klubi gjerman nuk u trembet spanjollëve e as Leo Messit. "Do ta përgatisim ndeshjen ashtu si gjithë të tjerat. Duam ta tregojmë forcën tonë, të përqendrohemi 100 % dhe t'i tregojmë vlerat tona në fushën e lojës. Nuk do t'i përqendrojmë forcat tona vetëm te Messi, por tek e gjithë skuadra. Njësoj vlen edhe për ne, nëse duam të kalojmë në turin tjetër, nevojitet një punë e madhe grupi dhe jo individ. Jam i bindur se nëse luajmë ashtu siç kemi bërë në muajt e fundit, gjithçka do të jetë më e lehtë për ne. Edhe pse rreziku për t'u eliminuar para kohe është i madh për faktin se luhet vetëm me një takim dhe çdo gabim mund të kushtojë shumë për skuadrën", ka thënë Flick.



**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se shoqëria » LOI Group « SH.P.K., me seli në PRIZREN, WILLIAM WALKER P.N., ka marrë vendim që ta shuaj Shoqërinë me NRB. dhe NRF. 810167503 me likuidim vullnetar dhe e ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së likuidimit vullnetar.

I njoftojmë të gjithë klientët që kanë raporte kreditore-debitore me këtë shoqëri që të paraqiten në afatin prej 30 ditësh nga data e shpalljes së likuidimit vullnetarë në gazetë.

**O B A V E Š T E N J E**

Obavještavamo sve kliente da društvo » LOI Group « D.o.o., sa sedištem u PRIZREN, WILLIAM WALKER P.N. doneo je odluku o gašenju biznisa sa REG.Br. i FBR. 810167503 putem dobrovolne likuidacije i ujedno imenovao likuidatora o vodjenju postupka dobrovoljne likuidacije.

Obaveštavaju se svi klienti koji imaju potraživanja i obaveze u navedenom društvu, da se jave u roku od 30 dana od dana oglašavanja dobrovoljne likuidacije u novini.

**A N N O U N C E M E N T**

We inform all clients that the company » LOI Group « L.L.C., based in PRIZREN, WILLIAM WALKER P.N., has taken the decision to cancel the company with Busines and Fiscal No. 810167503 and with voluntary liquidation and has appointed a liquidator for the development of voluntary liquidation proceeds.

We notify all clients that have credit - debit reports with this company to appear within 30 days from the date of announcement of voluntary liquidation in the newspaper.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se "Smart Solutions", SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me NRB: 811182203, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit.

Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**O B A V E Š T E N J E**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Smart Solutions" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa bisnisom: 811182203, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**A N N O U N C E M E N T**

All clients are to be informed that the "Smart Solutions" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811182203 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se shoqëria » Digital Head « SH.P.K., me seli në PRIZREN, WILLIAM WALKER P.N., ka marrë vendim që ta shuaj Shoqërinë me NRB. dhe NRF. 810167496 me likuidim vullnetar dhe e ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së likuidimit vullnetar.

I njoftojmë të gjithë klientët që kanë raporte kreditore-debitore me këtë shoqëri që të paraqiten në afatin prej 30 ditësh nga data e shpalljes së likuidimit vullnetarë në gazetë.

**O B A V E Š T E N J E**

Obavještavamo sve kliente da društvo » Digital Head « D.o.o., sa sedištem u PRIZREN, WILLIAM WALKER P.N. doneo je odluku o gašenju biznisa sa REG.Br. i FBR. 810167496 putem dobrovolne likuidacije i ujedno imenovao likuidatora o vodjenju postupka dobrovoljne likuidacije.

Obaveštavaju se svi klienti koji imaju potraživanja i obaveze u navedenom društvu, da se jave u roku od 30 dana od dana oglašavanja dobrovoljne likuidacije u novini.

**A N N O U N C E M E N T**

We inform all clients that the company » Digital Head « L.L.C., based in PRIZREN, WILLIAM WALKER P.N., has taken the decision to cancel the company with Busines and Fiscal No. 810167496 and with voluntary liquidation and has appointed a liquidator for the development of voluntary liquidation proceeds.

We notify all clients that have credit - debit reports with this company to appear within 30 days from the date of announcement of voluntary liquidation in the newspaper.

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

► "Krasniqi" Sh.P.K shpall të pavlefshme certifikatën e regjistrimit: 70917890

► Sherif Ademi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf " Ibrahim Fehmiu " Arbane

► Rushadije Ajazaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " Dëshmorët e Zhurit " Zhur

► Aida Alija shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " Ekrem Rexha " Lubizhd

► "3A ELEKTROSERVISI" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër 601541958.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërrlok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**

Qeveria - Vlada - Government  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES

AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR  
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr:194/1  
Dt: 11.08.2020

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 4, Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Ligji Nr. 06/L – 114 për Zyrat e Publikë, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2018, Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

## KONKURS

**Për plotësimin e vendeve të lira në dhe Sh. M. M “Shtjefen Gjeqovi”, në Prishtinë, Qendra e Kompetencës në Prizren për vitin shkollor 2020/2021**

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i lirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
Sh. M. M	“Shtjefen Gjeqovi”	Prishtinë	Një (1) mësimdhënës/e për lëndën Matematikës me 17 orë mësimore;	Vend i lirë
			Një (1) mësimdhënës/epër lëndë profesionale të makinerisë (dega termoteknikë) dhe Termoteknikë me 12 orë mësimore;	Vend i lirë Zëvendësim deri në kthimin e mësimdhënësit në punë
			Një (1) mësimdhënës/e për lëndet e Transportit dhe Trafikut me 15 orë mësimore;	Zëvendësim deri në kthimin e mësimdhënësit në punë
			Një (1) mësimdhënës/e për lëndet profesionale për lëmin e Transportit dhe Trafikut me 10 orë mësimore;	Zëvendësim deri në kthimin e mësimdhënësit në punë
			Një (1) mësimdhënës/e për lëndët e Elektroteknikë dhe Elektronikë, me 10 orë mësimore;	Vend i lirë
SHML	Qendra e Kompetencës	Prizren	Dy (2) mësimdhënës /e për profilin e TIK norme e plotë;	Vend i lirë
			Një (1) mësimdhënës /e për lëndën e Matematikës zëvendësim normë e plotë;	Zëvendësim deri në kthimin nga pushimi i lehonisë
			Një (1) instruktor/e për lëndën e instruktore turizmit;	Zëvendësim deri në kthimin nga pushimi i lehonisë

### Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPARr-së.

- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe procese mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

### Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi ( fotokopje );
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar pranohen dhe kandidatët me kualifikime të përafërt në afat të caktuar.

### Detyrat dhe Përgjegjësitë për Instruktor;

- Instruktori është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e praktikës profesionale.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të praktikës profesionale dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

### Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për instruktor:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 6 sipas KKK;
- Instruktor profesional me kualifikim: post sekondar, arsim të mesëm të lart;
- Të ketë më së paku 5 vjet përvojë punë në profesion në ndërmarrje biznese dhe institucione tjera;
- Letërnjoftimi ( fotokopje );
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar pranohen dhe kandidatët me kualifikime të përafërt në afat të caktuar.

### Procedurat e konkurrimit:

Afati i konkurrimit është 15 ditë pas shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Sh. M. M “Shtjefen Gjeqovi”, në Prishtinë, Qendra e Kompetencës Prizren. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës. Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale. Në mungesë të kandidatëve me kualifikim adekuat në intervistë thirren edhe kandidatët me kualifikim të përafërt, në të kundërtën intervistohen vetëm kandidatët me kualifikim përkatës.



N.P.L. "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. GJAKOVË  
 Komuna e Gjakovës  
 Opština Djetkovice Gjakove Municipality

K.E: 0390/324 010  
 E-mail: opibnall@stacioni.com  
 Info: 0390/324 268  
 Web:

Nr. 209  
 Data: 10.08.2020

**FTESË PËR ANKAND PUBLIK**  
**QIRADHËNIE TË LOKALEVE DHE HAPËSIRAVE PËR LOKAL AFARIST NË**  
**N.P.L. "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A., GJAKOVË.**

N.P.L. "Stacioni i Autobusëve" SH.A., Gjakovë njofton të gjithë të interesuarit se ofron lokalet dhe hapësirat për qiradhënie përmes Ankandit Publik si në vijim:

NR.	NJËSIA	Sipërfaqe m <sup>2</sup>	Çmimi Fillestar €
1.	Lokal Afarist (ish - posta)	35 m <sup>2</sup>	200.00 €
2.	Lokal Afarist (kati i II)	44 m <sup>2</sup>	100.00 €
3.	Hapësirë/sipërfaqe për shfrytëzim lokal afarist	14 m <sup>2</sup>	300.00 €

**Shënim: Të gjitha çmimet janë pa TVSH.**

**Kriteri i dhënies së kontratës është:** çmimi më i lartë i ofruar.

Preferencat e dëshirueshme për lëshimin e hapësirave me qira:

- Për lokalin Nr.1 preferohet zyrë postare, call center, apo veprimtari tjetër e ngjashme.
- Për lokalin Nr.2 preferohet zyrë përfaqësuese, frizer/e apo veprimtari tjetër e ngjashme.
- Për hapësirën për shfrytëzim lokal afarist Nr.3 preferohet dhe destinohet si agjension turistik, zyrë përfaqësuese ose të ngjashme, bazuar dhe në veprimtaritë dhe strukturën.

Hapësira Nr.3 e cila ofrohet për dhënie në shfrytëzim me qira për lokal afarist përfshin sipërfaqe prej 14m<sup>2</sup>. Sipërfaqja e ofruar në shfrytëzim është konform planit të Situacionit dhe shumë e përshtatshme për veprimtari afariste.

Hapësira Nr.3 momentalisht nuk është e gatshme për ushtrimin e punëve afariste, andaj ofertuesit duhet të kryejnë investime në mënyrë që të kompletohet si lokal afarist dhe të jetë i gatshëm për shfrytëzim.

**Lloji i investimit:** Nisur nga kjo për hapësirën Nr.3 ofertuesit duhet të paraqesin projektin e tyre për ndërtim të lokalit me rrethim xhami dhe standardet tjera mbështetëse pullazin, dyshemenë nga keramika, instalimin e kanalizimit, rrjetin e ujësjellësit, energjinë elektrike dhe pajisjet tjera mbështetëse për funksionalizim. Ofertuesi duhet bashkëngjitur: skicat dhe sipërfaqet e sakta për investim dhe shfrytëzim, fotografitë e projektit, vlerën totale të investimeve së bashku me pozicionet me elementet për investim. Investitori duhet të ketë konsideratë ruajtjen e strukturës si dhe hapësirave qarkulluese.

**Ofertuesi duhet të ofertojë çmimin e qirasë mujore në total.**

**Kostoja e investimeve nuk do të zbritet në qiranë mujore.**

**Afati për kryerjen e investimeve do të jetë 30 ditë.**

**Ofertuesi obligohet të rikthejë në gjendjen e mëparshme dëmtimet që mund të shkaktohen gjatë punimeve të instalimit të rrjetit të kanalizimit, ujësjellësit dhe punimeve tjera, dhe të gjitha këto detaje do të definohen në parakontratën e cila do të nënshkruhet nga palët para fillimit të punimeve duke theksuar kriteret e lartcekura.**

**E drejta e shfrytëzimit nuk lejohet të bartet tek pala e tretë.**

Fituesi i marrjes në shfrytëzim me qira të hapësirës për lokal afarist do të shpallet ofertuesi i cili ofron çmimin **më të lartë.**

**Afati i dhënies në shfrytëzim me qira për lokalet Nr.1 dhe Nr.2 do të jetë 1 vit me mundësi vazhdimi.**

**Afati i dhënies në shfrytëzim me qira për hapësirën Nr.3 për lokal afarist do të përcaktohet me marrëveshje dy palëshe.**

Informata shtesë mund të merren në zyrat e N.P.L. "Stacioni i Autobusëve" SH.A., Gjakovë, çdo ditë pune nga ora 09:00 – 14:00.  
 Poashtu të interesuarit gjatë këtij intervali kohorë mund të inspektojnë lokalet dhe hapësirat për shfrytëzim si lokal afarist në fjalë.

Të drejtë pjesëmarrje kanë si **personat fizik** ( të cilët duhet të sjellin një kopje të lehtënjofimit dhe vërtetimin nga gjykata se nuk janë nën hetime) ashtu dhe **personat juridik** ( të cilët duhet të sjellin një kopje të certifikatës së biznesit dhe vërtetimin nga gjykata se firma nuk është nën hetime).

Të interesuarit janë të obliguar t'i paraqesin ofertat e tyre përmes plotësimit të formularit me shkrim, duke bashkëngjitur edhe dokumentacionin përcjellës të lartcekur, në pliko të mbyllur, në zyrën e Shërbimit Juridik të Ndërmarrjes, çdo ditë pune nga ora 09:00 deri në ora 14:00.



Ankandi mбетet i hapur nga datë 10.08.2020 deri më 25.08.2020, në ora 14:00.

Hapja e ofertave do të bëhet më datë 26.08.2020 në ora 12:00 në sallën e madhe në katin I të N.P.L. "Stacioni i Autobusëve" SH.A., Gjakovë, nën praninë e komisionit.

**Obligimet e operatorëve fitues**

- Orë matësi i rrymës dhe ujit duhet të jetë i ndarë dhe i regjistruar në emër të investitorit fitues.
- Për çdo investim brenda dhe jashtë lokalit duhet paraprakisht të merret leja me shkrim nga qiradhënësi
- Obligimet tjera të qiramarrësit do të definohej me kontratë e cila do të përpilohet pas marrëveshjes.

Kryeshefi Ekzekutiv - z.Flamur Bicurri






# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  [www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT




# SWISS

## TAVERNA




Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553


PRISHTINË





# Lumë's Details


## Estetik & Depilim



 044 900 978 | 045 681 898

 Sallon Depilimi Lumë's Details

 lumessedetails

 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi





# ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

- Quality & Sales Award Recipients**  
[Listed in alphabetical order]
- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
  - ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
  - ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
  - ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
  - ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
  - ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
  - ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
  - ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
  - ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
  - ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

